FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 73

Tiranë – E martë, 22 maj 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 9.5.2018	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të Planit të Veprimit	4607
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 294, datë 15.5.2018	Për një ndryshim në urdhrin nr. 611, datë 1.12.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme, "Për procedurën dhe rregullat për dërgimin e rastit, nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët	4644
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 305, datë 21.5.2018	Për delegimin e kompetencave	4644
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 97, datë 23.4.2018	Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018	4644
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 31, datë 27.4.2018	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr.4, datë 29.2.2012, "Për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë"	4545
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 32, datë 27.4.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 2.3.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Libohovë"	4646
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 33, datë 11.5.2018	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjellës Gramsh sh.a	4647

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 34, datë 11.5.2018

Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a..... 4649

VENDIM
Nr. 259, datë 9.5.2018

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN 2018–2024 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe të planit të veprimit të saj, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe të gjitha institucionet e përmendura në strategjinë dhe planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E PËRMBAJTJES

STRATEGJIA KOMBËTARE E DIASPORËS
2018–2024
DHE PLANI I VEPRIMIT

HYRJE
DIASPORA SI CILËSI KOMBËTARE
I. KUSHTET AKTUALE
I.1 Situata aktuale, si edhe vlerësimi i situatës
I.2 Fazat e migrimit shqiptar dhe diaspora
I.3 Faktorët e zhvendosjes së shqiptarëve
I.4 Fenomeni i "ikjes së trurit"
I.5 Migrimi dhe fqinjët
I.6 Faktorizimi social dhe politik
I.7 Gjendja aktuale e diasporës
I.8 Diaspora dhe integrimi në BE
I.9 Shqipëria dhe Kosova
II. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË
II.1 Vizioni, misioni
II.2 Objektivat strategjikë
III. OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT
III.1 Krijimi i një kuadri të plotë të politikëbërjes mbi diasporën
III.1.1 Shteti dhe diaspora
- Agjencia Kombëtare e Diasporës
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës
- Qendra për Botimet në Diasporë
- Komiteti Shtetëror për Diasporën
- Samiti i Diasporës
- Këshilli Koordinativ i Diasporës
- Diaspora dhe menaxhimi shtetëror
- Shërbimet konsullore dhe diplomacia
- Marrëdhënia e shtetit me diasporën
- Krijimi i Regjistrit të Organizatave të Diasporës
- Ngritja e qendrave kulturore shqiptare
- Promovimi i të drejtave të diasporës
- Politika shtetërore dhe diaspora
- Organizimi i komuniteteve shqiptare në diasporë
- E drejta e votës
- Nënkomisioni Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin
- Diplomacia publike e diasporës
III.2 Krijimi i një instrumenti të dobishëm në ndihmë të qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me diasporën dhe migracionin e ligjshëm
III.2.1 Përfshirja e diasporës në ekonominë kombëtare
- Remitancat - nga konsumi drejt zhvillimit
- Diaspora - kontribuese e zhvillimit të Shqipërisë
- Rrjetet e diasporës
- Instrumente të dobishme
III.3 Përgatitja e administratës për nivelin e ri të marrëdhënies të politikës shtetërore me diasporën
III.3.1 Komunitetet shqiptare jashtë vendit dhe zhvillimi ekonomik
IIII.3.2 Mbrojtja e identitetit dhe trashëgimia kulturore
- Kapitali human, social dhe kulturor
- Ruajtja e identitetit kombëtar
- Arsimimi, edukimi dhe media
IV. KOSTIMI DHE BUXHETIMI
V. MONITORIMI DHE ZBATIMI
V.1 Monitorimi
Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018–2024
Grupi i punës

HYRJE
DIASPORA SI CILËSI KOMBËTARE

Diaspora është një term i njohur më shumë se 2500 vite më parë. Sot kjo fjalë mund të përcaktohet si "bashkësi migrantësh, që ruajnë lidhjet materiale apo sentimentale me atdheun, duke u adoptuar në mjedisin dhe institucionet e shoqërisë mikpritëse". Diaspora nuk duhet kuptuar si diçka e pandryshueshme dhe e ngurtë, as si moment social unitar apo i kornizuar. Përkundrazi, për diasporën duhet folur si për komunitete migrantësh, identiteti dhe cilësitë e të cilëve ndryshojnë me kalimin e kohës.

Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia (Lugina) janë hapësira, që përfshijnë shtetet dërguese të shqiptarëve për migrim.

Diaspora shqiptare është tradicionale. Rreth 200 000 njerëz migruan kur osmanët pushtuan tokat shqiptare në shekullin XV. Më vonë, shqiptarët lëviznin brenda territorit osman, dhe mbanin, gjithashtu, pozita të rëndësishme në strukturat osmane në vende të ndryshme të Perandorisë.

Një prej diasporave më të vjetra shqiptare është komuniteti arbëresh në Itali, i cili akoma ruan rrënjët e veta kulturore dhe gjuhësore. Kjo popullatë është pasardhëse e atyre familjeve shqiptare, që udhëhiqnin Shqipërinë në shekullin XV kur osmanët pushtuan këtë zonë dhe ata u bën refugjatë kryesisht në Mbretërinë e Napolit.

Diasporë me origjinë shqiptare gjendet në Turqi. Për një kohë të gjatë ishte e rrezikshme të deklarohej prejardhja shqiptare, por në Turqinë e sotme, diaspora shqiptare është e respektuar dhe historiografia turke çmon rolin e rëndësishëm që kanë luajtur shqiptarët në hierarkinë osmane, por edhe më vonë në kohën e themelimit të shtetit modern të Turqisë.

Migracioni për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është i konsoliduar në kohë dhe në vitin 2012, shoqata më e vjetër kulturore shqiptare "Vatra" festoi përvjetorin e saj të 100-të.

Në Rumani, Kroaci, Bullgari, Ukrainë, Egjipt deri në Argjentinë ekziston një diasporë, e cila edhe pse e vjetër ruan lidhjet gjuhësore dhe është në kërkim të identitetit të vet.

Sot, diaspora shqiptare është e pranishme në shtetet evropiane, Kanada, Australi dhe në Afrikë. Në shumicën e vendeve mikpritëse, shqiptarët kanë themeluar organizatat e tyre.

Në trajtimin e diasporës shqiptare organizatat ndërkombëtare fokusohen kryesisht vetëm në atë aktuale. Bëhet fjalë për ata që janë larguar nga Shqipëria dhe Kosova pas rënies së komunizmit në vitet 1990-të dhe më vonë. Ky përkufizim është i mangët dhe nuk përfaqëson realitetin e diasporës shqiptare. Shumë nga ata që u larguan në vitet '90, u bashkuan me familjarët apo miqtë e tyre, që tashmë po jetonin jashtë vendit. Ata u janë bashkuar shoqatave shqiptare, që ekzistonin prej kohësh në shumë vende mikpritëse.

Migrimi mbetet një sfidë e vështirë për institucionet shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare është t'i sigurojë Shqipërisë një politikë gjithëpërfshirëse për diasporën dhe vendosjen e saj në një linjë me orientimet e politikës së integrimit të Bashkimit Evropian dhe trajtimin e saj me standardet më të mira ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare mbështet migrantët që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme. Ajo synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve të vet, që jetojnë jashtë vendit.

Strategjia nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë. Ajo nuk mbulon çështjet që lidhen me shtetasit e huaj që jetojnë ose duan të jetojnë në Shqipëri.

Strategjia synon që nëpërmjet politikave të bashkëpunimit me diasporën dhe migrantët të forcojë dhe lehtësojë marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tyre pritëse.

Strategjia e konsideron diasporën vlerë të shtuar të shoqërisë shqiptare dhe parashikon rritjen e aftësive të qeverisë për politikbërjen ndaj saj. Ajo mbështet organizimin e komuniteteve shqiptare në botë, në një diasporë të strukturuar, me qëllim faktorizimin e tyre në bashkëveprimin për përshpejtimin e zhvillimit të vendit.

Dokumenti kërkon rivlerësimin e diasporës si një faktor, i cili do të ushtrojë ndikimin e saj në vendlindje dhe anasjelltas, duke përshtatur kombin me kushtet e reja të kohës që jetojmë.

Dokumenti ndahet në dy pjesë: Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit, i cili përmban objektivat dhe aktivitetet që planifikohen të përmbushen në periudhën 2018–2024.

Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2018 – 2024 të Republikës së Shqipërisë është hartuar me kontributin e dhënë nga Grupi i Punës Ndërministror i drejtuar nga ministri i Shtetit për Diasporën. Në këtë proces janë përfshirë edhe ekspertë të ardhur nga ministri dhe institucione të ndryshme. Në këtë dokument janë përfshirë kontributet dhe propozimet të bëra nga shoqëria civile.

I. KUSHTET AKTUALE

1.1 SITUATA AKTUALE, SI EDHE VLERËSIMI I SITUATËS

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018–2024 është një instrument, i cili trajton gjendjen e fenomenit migrator dhe diasporës së Shqipërisë. Ajo jep një numër rekomandimesh, të cilat do të mund të qartësojnë punën e ardhshme të strukturave shtetërore.

Kompleksiteti i fenomenit të diasporës kërkon koordinimin e shumë institucioneve dhe organeve shtetërore dhe përcakton natyrën e dokumentit strategjik, si një strategji komplekse ndërdisiplinore. Të njëjtën natyrë pune ndoqi edhe përgatitja dhe përpunimi i Planit Kombëtar të Veprimit. Ky i fundit nëpërmjet masave të veta, do të bëjë të mundur zbatimin e Strategjisë Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2018–2024.

Strategjia Kombëtare është një dokument dinamik, i cili e ka të nevojshëm ndjekjen, përshtatjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të saj. Strategjia do të jetë një instrument i vlefshëm për qytetarët e interesuar dhe do të nxisë strukturat shtetërore, për realizimin e detyrimeve të parashikuara në të.

Në Shqipëri, politikat publike ndaj diasporës deri tani janë ndikuar nga komuniteti i donatorëve dhe OJQ-të. Në vitin 2004, Shqipëria miratoi "Strategjinë Kombëtare të Migracionit 2005–2010", për menaxhimin e migrimit në mënyrë sa më të plotë. Ai ishte dokumenti i parë, që provoi të përfshijë interesat e shqiptarëve brenda edhe jashtë vendit në profilin e një politike shtetërore. Strategjia e parë shqiptare për migrimin e vitit 2004 kërkonte, që Shqipëria të konsiderohej vend i aftë për menaxhimin e rrjedhave të migrimit. Ajo u përgatit me financim të BE-së dhe përkrahur nga IOM-i. Pavarësisht dëshirës, synimi kishte pak të bënte me zhvillimin ekonomik të vendit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018–2024 është mbështetur edhe në vlerësimin kritik të zbatimit të politikave të qeverive shqiptare në fushën e migracionit nëpërmjet:

- studimit të strategjive të mëparshme në fushën e migracionit dhe të planveprimeve të tyre;
- verifikimit të masave të ndërmarra dhe të ndikimit të tyre në veprimin shtetëror;
- verifikimit të arsyeve të vonesave dhe masat që duhen marrë në vazhdim;
- analizimit të kushteve ekzistuese për realizimin e qëllimeve;
- hartimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve për zhvillimin e politikës shtetërore mbi këtë çështje.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare, trajton:

- shkaqet e migracionit;
- mekanizmat e faktorizimit social dhe politik të diasporës në shoqërinë shqiptare;
- mbrojtjen e komuniteteve shqiptare të diasporës jashtë Shqipërisë;
- organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit;
- përmirësimin e shërbimeve konsullore nga ana e konsullatave dhe ambasadave shqiptare.

1.2 FAZAT E MIGRIMIT SHQIPTAR DHE DIASPORA

Diaspora është e ndërlidhur me procesin e "pjekurisë" së migrimit. Në raport me të, për Shqipërinë e periudhës kohore të fundit, mund të identifikojmë tri faza të migracionit:

- vala e migrantëve para vitit 1944;
- diasporën më të vonshme të atyre, që u larguan gjatë viteve 1945–1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi;
- valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit, pas vitit 1990.

Në vitin 1989, rreth 19.5% e popullatës i përkiste grup-moshës 15–24 vjeç. Izolimi politik i regjimit komunist dhe ideja e lirisë në Perëndim, u personifikuan si ide të lirisë së lëvizjes dhe migrimin drejt shteteve fqinje, kryesisht në Itali dhe Greqi. Lëvizja jashtë vendit shihej si një investim për të ardhmen dhe për një jetë më të mirë.

Fig. 1. Popullsia mesatare vjetore dhe dy komponentët kryesorë (Shtesa Natyrore dhe Migracioni Neto), 2017



Burimi: INSTAT

Shqipëria u bë vendi me fluksin më të madh të migrimit në Evropë, sipas matjes së raportit mes migrantëve dhe popullsisë. Kjo fazë e migrimit mund të ndahet në disa periudha:

- periudha 1991–1992, e cila ishte tërësisht e pakontrolluar, kur përafërsisht 300 000 shqiptarë braktisën vendin,
- periudha e viteve 1992–1996, kur po aq migruan, kryesisht ilegalisht, përkundër përmirësimeve të përkohshme të ekonomisë dhe kontrollit më të mirë kufitar,
- periudha 1996–1997, menjëherë pas krizës së rënies së skemave piramidale të kursimeve të një numri të konsiderueshëm njerëzish. Shqipëria u zhyt në anarki dhe shumë të tjerë u shpërngulën nga frika e dhuna,
- periudha pas vendosjes së lëvizjes së lirë të njerëzve ku ata mund të lëviznin lirisht vetëm me pasaportën shqiptare.

Fig. 2. Numri i imigrantëve, emigrantëve dhe migracioni (neto)



Burimi: INSTAT

Gjatë dekadës së parë së tranzicionit u shfaq një mungesë e kontrollit qeveritar mbi migrimin. Në fillim të viteve 2000, përafërsisht 25% e popullatës së përgjithshme, apo mbi 35% e fuqisë punëtore, kishte emigruar.

1.3 FAKTORËT E ZHVENDOSJES SË SHQIPTARËVE

Njerëzit migrojnë kur në vendin e tyre mungojnë burimet dhe mundësitë për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre. Termi, "Për një jetë më të mirë" përfshin disa faktorë të cilët i detyrojnë shqiptarët të largohen nga vendi. Kjo është e reflektuar në mungesën e njëtrajtshmërisë ndërmjet migrantëve shqiptarë.

Faktorët kryesorë janë kryesisht:

- Faktori ekonomik: shqiptarët janë larguar kryesisht për arsye ekonomike, siç janë: - mungesa e mundësive të punësimit, - kushtet e vështira të jetesës, veçanërisht në disa zona ku mungojnë kushtet elementare si energjia elektrike, uji dhe strehimi.

- Siguria publike: Shqipëria është përballur me flukse masive emigratore si pasojë e nivelit të ulët të sigurisë publike apo trazirave në vend. Një numër i madh i personash të kualifikuar, me kushte të mira ekonomike, janë larguar nga vendi për një të ardhme më të sigurt për veten dhe familjen e tyre. Kjo dukuri ka ndodhur veçanërisht pas trazirave të vitit 1997 dhe u shoqërua me një valë tjetër largimi.

- Institucionet e dobëta: çojnë në mungesën e besimit te qytetarët për përmirësimin e situatës në vend, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Institucionet e dobëta dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit, gjithashtu, ndikojnë në përpjekjet dhe perspektivat e emigrantëve për t'u kthyer dhe vendosur në vend, veçanërisht kur ata hasin vështirësi në ndërtimin e aktiviteteve private, apo në marrëdhënie me administratën publike.

Një rast i veçantë, janë largimet për shkak të traditës së "gjakmarrjes", të cilat kanë një ngarkesë sociale dhe kulturore të veçantë në zonat veriore të vendit.

Arsyet e largimit kanë ndryshuar peshën me kalimin e kohës. Në një studim i cili tregon arsyet e largimit nga Shqipëria në vitin 2017, sipas INSTAT-it, vlerësohen në pesë kategori faktorët e largimit nga vendi.

Fig. 3. Faktorët e largimit nga Shqipëria, 2017



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, nga INSTAT-i, 2017

Ndër faktorët kryesorë në kushtet e lëvizjes së lirë në hapësirën e Bashkimit Evropian mundësia për të punuar jashtë vendit zë vendin e parë (në rastet e individëve të cilët kanë qenë të punësuar edhe në Shqipëri 84%), pastaj vjen faktori familjar (4.6%), i cili ndiqet nga faktori i papunësisë si pamundësi (4.2%), mundësitë e studimit (3.5%) dhe faktorë të tjerë (3.6%).

Në dokumentet e mëparshme qeveritare largimi nga vendi është trajtuar kryesisht në kuadrin e masave kundër trafikimit dhe menaxhimit të kufijve. Nga vetë natyra e tij, ai nuk mund të luftohet me masa represive, por, gjithashtu, kërkohen masa parandaluese. Fenomeni kërkon reflektim në trajtimin me metoda afatgjata të përqendruara në shkaqet e migracionit në një këndvështrim praktik. Ky qëndrim duhet të konsiderojë përputhjen me Politikat e Përbashkëta Evropiane për Migracionin.

1.4 FENOMENI I "IKJES SË TRURIT"

Niveli i lartë i largimit të njerëzve të kualifikuar është një karakteristikë e migrimit të shqiptarëve të Shqipërisë, krahasuar me shqiptarët nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

Në 1990, 40% e arsimtarëve dhe studiuesve u larguan nga Shqipëria. Në fillim të viteve 2000, rreth 60 për qind e të diplomuarve në vendet perëndimore ose ishin larguar nga vendi ose nuk ishin kthyer pas diplomimit.[1]

Shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e profesionistëve të kualifikuar kanë gjetur punë në sektorë që ndryshojnë nga kualifikimi i tyre.

Largimi i "trurit" përfshin akademikët, personat e kualifikuar në fushat të ndryshme, si edhe një numër të konsiderueshëm studentësh shqiptarë që studiojnë në universitete të huaja. Nga Italia e Greqia, "truri" i vendit largohet në drejtim të: Kanadasë, SHBA-së, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe vendeve të tjera të BE-së.

Fenomeni "Brain Drain" është etiketuar në mënyrë simbolike si fenomeni "Kanada", duke qenë se politikat e emigracionit të qeverisë së Kanadasë favorizojnë emigrimin e njerëzve të kualifikuar.

"Humbja" e personave të kualifikuar dhe të arsimuar vlerësohet si një dëm i zhvillimit social-ekonomik të një vendi, pasi ata janë forca drejtuese e çdo vendi.

Marrja e masave për të shmangur largimin e përhershëm të individëve të kualifikuar dhe të arsimuar kërkon nxitjen dhe promovimin e migracionit të përkohshëm, në veçanti të migracionit qarkullues të individëve të kualifikuar.

Qeveria e Shqipërisë synon të nxisë kthimin vullnetar të emigrantëve të kualifikuar, të përhershëm ose të përkohshëm, nëpërmjet qëndrimeve afatshkurtra për qëllime konsultimi, mësimdhënie apo trajnimi. Kësaj do t'i shërbejë edhe evidentimi i të gjithë kapaciteteve intelektuale që ndodhen jashtë vendit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të nxisë përfaqësuesit e brezit të ri të talentuar jashtë vendit të tërhiqen drejt një karriere profesionale në vend. Një mundësi do të jetë ofrimi i bursave për studime të mëtejshme jashtë vendit dhe krijimi i mundësive për pjesëmarrje në programe për shkëmbime eksperiencash me vendet e treta, me kushtin e detyrimit për t'u kthyer. Ky do të konsiderohet një investim për të ardhmen duke rritur nivelin e akademikëve të rinj. Për të siguruar kthimin e tyre, institucionet (dërguese) do të mbajnë marrëdhënie të afërta me migrantët dhe përfaqësuesit e diasporës së kualifikuar dhe do t'u ofrojnë atyre mundësi punësimi në atdhe.

1.5 MIGRIMI DHE FQINJËT

Në përzgjedhjen e shtetit mikpritës faktor kryesor për migracionin e ri shqiptar ishte afërsia gjeografike, kulturore dhe gjuhësore. Fqinjët si Greqia dhe Italia ishin destinacionet kryesore gjatë periudhës së viteve 1992–1995. Vendet e lartpërmendura janë parapëlqyer edhe për shkak të mundësive të pakta për të zbatuar një projekt të kushtueshëm migrimi. Parapëlqimi i migrantëve shqiptarë për shtetet e tjera të Evropës Perëndimore, apo SHBA-së u kufizuan për shkak të gjendjes ekonomike dhe politikave të migrimit në këto vende.

[1] CESS (2003) *From Brain Drain to Brain Gain: Mobilizing Albania's Skilled Diaspora.* (*Nga ikja e trurit në kthimin e trurit: mobilizimi i diasporës së kualifikuar të Shqipërisë.*) Dokumenti i politikave për qeverinë e Shqipërisë. Përgatitur nga Qendra për Studime Sociale dhe Ekonomike, në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore të Zhvillimit për Migracionin, Globalizimin dhe Varfërinë, Universiteti i Sussex, UK, Tiranë, prill 2003.

Statistikat e migrimit janë të qarta në paqartësinë e tyre. Njëzet vite pas rënies së komunizmit vlerësohej se përafërsisht 1,44 milionë shqiptarë, respektivisht 45 % e popullsisë prej 3,2 milionë që aktualisht jetojnë në Shqipëri, kishin migruar dhe jetonin jashtë vendit, kryesisht në Greqi dhe Itali. Qeveria e Shqipërisë vlerësonte që në vitin 2005 në Greqi jetonin 600 000 shqiptarë, ndërsa në Itali 250 000 (ndonëse burimet italiane pretendonin se gjendeshin rreth 400 000 shqiptarë).

Nëse marrim për bazë të dhënat e "peoplemovin"[2], i cili i referohet gjendjes së migracionit, mund të diskutohen këto të dhëna mbi Shqipërinë (fig. 4).

Fig. 4. Migrantët shqiptarë sipas vendeve kryesore të destinacionit

Migrantë	
Greqi	676 846
Itali	522 647
Maqedoni	91 128
Amerikë	83 018
Gjermani	15 964
Kanada	11 985
Turqi	3 712
Angli	3 065
Francë	3 037
Australi	2 628

Burimi: Peoplemovin

Italia për shqiptarët përbënte një vend ku kombinohen parapëlqimet kulturore dhe afërsia gjeografike. Jetesa nën regjimin komunist të vendit, kishte bërë që Italia të shihej si simbol i lirisë dhe Perëndimit. Transmetimet në radio dhe televizion ishin rrugët më të rëndësishme përmes së cilave shqiptarët në komunizëm ruanin lidhjet me Perëndimin. Italishtja ishte gjuha më e folur e huaj në Shqipëri, arti dhe kultura italiane përbënin tërheqje të veçanta. Të gjithë këta faktorë ndihmojnë të kuptohet përse Italia ishte vendi më i kërkuar nga emigrantët shqiptarë. Në Itali numri i shqiptarëve në mesin e vitit 2005 ishte më i larti krahasuar me emigrantët e tjerë në atë vend, respektivisht 13,7% më shumë se rumunët dhe marokenët.

Duke iu referuar të dhënave të Institutit të Statistikave Italiane, në vitin 2005 emigrantët shqiptarë në Itali ishin në vendin e parë me 348 813, në vendin e dytë vinin rumunët me 297 570.

Greqia është shteti tjetër i cili është gjeografikisht i afërt me shqiptarët. Kalimi ilegal i kufirit greko-shqiptar nuk kërkonte shpenzime të mëdha financiare. Shtetasit e të dy vendeve, gjithashtu, ndajnë ngjashmëri të caktuara kulturore dhe historike. Edhe pse greqishtja nuk flitet në Shqipëri, por vetëm në disa rajone jugore ku banon komuniteti grek, migrimi masiv në drejtim të këtij vendi ka përfshirë një numër të shtuar të shqiptarëve. Kjo solli rritjen e lartë të atyre që mund të flisnin greqisht, duke shkurtuar edhe distancën kulturore e gjuhësore mes dy vendeve fqinje.

Studiuesit e përshkruajnë migrimin nga Shqipëria si ekonomik dhe me një nivel të lartë parregullsie, me flukse emigrantësh pa dokumente dhe të zhvilluar shpejt e në mënyrë dinamike. Cilësi të veçantë migrimi shfaq (me shumë vajtje e ardhje) sidomos me Greqinë.

[2] "Peoplemovin" është një projekt eksperimental në vizualizimin e të dhënave, që tregon flukset e emigrantëve që nga 2010. Të dhënat e migrimit të ofruara nga Banka Botërore janë hartuar si një tabelë rrjedhëse që lidh emigracionin dhe vendet e destinacionit.

Fig. 5. Numri i emigrantëve dhe emigrantë për 1000 banorë



Burimi: INSTAT

Lëvizshmëria e migrantëve që udhëtojnë shpesh mes vendlindjes dhe vendeve mikpritëse është normalizuar për shkak të procesit rregullues (të statusit juridik) në Itali dhe Greqi dhe lëvizjes së lirë pa viza. Ky proces ka krijuar diasporën shqiptare në këto vende e cila fokusohet në stabilizimin e statusit social dhe juridik në vendet mikpritëse për brezin pasardhës.

6. FAKTORIZIMI SOCIAL DHE POLITIK

Një cilësi dalluese e migracionit shqiptar sidomos në Greqi dhe Itali është krijimi i organizatave bazuar në interesat e partive politike në Shqipëri. Ato kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkatdhetarëve që të marrin pjesë në votimet elektorale (duke udhëtuar drejt Shqipërisë). Në disa parti politike përfaqësuesit e këtyre organizatave janë pjesë e strukturave drejtuese duke rritur influencën politike të migracionit në politikën shqiptare.

Me rregullimin e statusit juridik në shoqëritë pritëse, veçanërisht në Itali dhe Greqi migrantët shqiptarë po shkojnë drejt marrjes së një roli të natyrshëm. Votat e tyre po vlerësohen të rëndësishme në proceset elektorale vendase. Kjo po krijon mundësi për përfaqësimin e kandidatëve me kombësi shqiptare në strukturat politike dhe përfaqësuese të vendeve pritëse.

Angazhimi i organizuar i migracionit në Itali dhe Greqi ka ndikuar dukshëm në marrëdhëniet e Shqipërisë me këto dy vende. Ato janë ngritur në nivelin e partneritetit strategjik duke qenë një shembull se si migracioni dhe diaspora ndikon në marrëdhëniet bilaterale midis dy shteteve.

7. GJENDJA AKTUALE E DIASPORËS

Analiza e gjendjes aktuale tregon se diaspora shqiptare është shumë dinamike. Ajo gjendet në shumë shtete udhëheqëse të botës si në Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Greqi, Itali, Turqi, Zvicër, Norvegji, Suedi, Finlandë dhe Francë, por, gjithashtu, edhe në fuqitë e reja ekonomike siç është Kanadaja dhe Australia.

Diaspora shqiptare është gjithnjë më e organizuar, e arsimuar dhe e gatshme të mbajë kontaktet me vendet e origjinës. Niveli aktual i remitancave të saj është i debatueshëm, por interesi kryesor ka të bëj me të ardhmen e këtyre të ardhurave.

Vlerësimi i organizatave shqiptare të diasporës dhe politikave të migrimit tregojnë për rolin në rritje që mund të luajë diaspora si një ndërmjetësuese mes vendeve mikpritëse dhe vendlindjes.

Organizatat e diasporës shqiptare në Perëndim, po përqendrohen edhe më shumë në mënyrën e organizimit më të mirë të tyre në vendet mikpritëse dhe përparësitë e tyre të brendshme. Ato po adresojnë situatën e anëtarëve të diasporës, të nevojave dhe kërkesave të tyre të ndërlidhura me pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e punëtorëve të huaj, shtetësinë dhe të drejtat e komuniteteve fetare.

Cilësia kryesore e diasporës shqiptare është mobilizimi edhe përmes lobimit indirekt për të bindur qeverinë pranuese që të veprojë në favor të mbështetjes të shtetit të prejardhjes. Një angazhim të tillë diaspora shqiptare e ka pasur në përpjekjet

për pavarësinë, së pari të Shqipërisë e pastaj të Kosovës. Aftësitë reaguese kanë qenë më të mira se sa ato me të cilat mund të krijohet një vetorganizim më i mirë.

Migrimi mbetet një sfidë e vështirë për institucionet shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare është t'i sigurojë Shqipërisë një politikë gjithëpërfshirëse për diasporën dhe vendosjen e saj në një linjë me orientimet e politikës së integrimit të Bashkimit Evropian dhe trajtimin e saj me standardet më të mira ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare mbështet migrantët që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme. Ajo synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve të vet, që jetojnë jashtë vendit.

Strategjia nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë. Ajo nuk mbulon çështjet që lidhen me shtetasit e huaj që jetojnë ose duan të jetojnë në Shqipëri.

Strategjia synon që nëpërmjet politikave të bashkëpunimit me diasporën dhe migrantët të forcojë dhe lehtësojë marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tyre pritëse.

Strategjia e konsideron diasporën vlerë të shtuar të shoqërisë shqiptare dhe parashikon rritjen e aftësive të qeverisë për politikbërjen ndaj saj. Ajo mbështet organizimin e komuniteteve shqiptare në botë, në një diasporë të strukturuar, me qëllim faktorizimin e tyre në bashkëveprimin për përshpejtimin e zhvillimit të vendit.

8. DIASPORA DHE INTEGRIMI NË BE

Diaspora dhe migrimi janë dy "enë" komunikuese në proces. Migrimi ka qenë një temë e rëndësishme e reflektimit të politikave të Bashkimit Evropian gjatë viteve të fundit. Strategjia Evropiane 2020 dhe Programi i Stokholmit pranojnë potencialin e lartë dhe kontributin e madh të migrantëve për BE-në, si edhe për ndërtimin e një ekonomie konkurruese dhe të qëndrueshme.

9. SHQIPËRIA DHE KOSOVA

Shqipëria dhe Kosova supozohet të jenë ndër vendet më të varfra të Evropës. Por, ky vlerësim ndodh vetëm nëse shikohet në vlerat e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Këto vlera nuk e japin pasqyrën e plotë për forcën ekonomike të kombit shqiptar. Në mesin e pasurive të fshehura të këtyre dy shteteve, duhet të llogaritet edhe diaspora e madhe dhe e shpërndarë nëpër shumë vende të botës, e cila dërgon rregullisht remitanca, duke mbartur kështu përgjegjësi të rëndësishme për mirëqenien e vendlindjes dhe popullsisë së saj.

Strategjia Kombëtare parashikon një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e shtetit të Kosovës për një rivlerësim të marrëdhënies me diasporën e përbashkët. Marrëveshjet në fushën e diasporës midis dy shteteve kanë shërbyer si një hap cilësor në këtë drejtim. Ndërtimi i një Plani Veprimi të përbashkët do të ishte i rëndësishëm sa edhe i detyrueshëm.

Të dyja shtetet do të vlerësojnë nivelin e përbashkët të bashkëpunimit edhe me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë për të koordinuar me institucionet përgjegjëse të tyre, rast pas rasti, të drejtat e diasporës shqiptare në vendlindje.

II. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

2.1 VIZIONI, MISIONI

Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare është konkluzion i reflektimit në lidhje me punën që duhet të kryejnë institucionet për krijimin e një politike të re shtetërore për diasporën.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare përkrah në rivlerësimin e situatës dhe strukturimin cilësor të raporteve të shtetit shqiptar me diasporën.

Diaspora dhe komunitetet shqiptare janë të lidhura me Shqipërinë dhe me njeri-tjetrin nga mënyra e të kuptuarit të interesave zhvillimore dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në kushtet e reja të shoqërisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Misioni i Strategjisë Kombëtare ka qëllim të përfshijë dhe fuqizojë pjesëmarrjen e diasporës dhe migrantëve si faktor të zhvillimit të Shqipërisë, nëpërmjet kapitaleve të dijeve dhe vlerave që ata zotërojnë.

Vlerat themelore që kërkon të realizojë ky dokument është krijimi i besimit dhe përfshirja e kontributit të diasporës shqiptare nëpërmjet përfitimit reciprok, lehtësimit me një politikë mbështetëse e cila ndryshon cilësinë e marrëdhënies dhe forcon lidhjet e shqiptarëve kudo që ndodhen me vendlindjen dhe njëri-tjetrin.

2.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Në realizimin e politikave ndaj diasporës, parashikimi dhe planifikimi strategjik do të çojnë

drejt të kuptuarit të rreziqeve kryesore të së ardhmes si për vendlindjen ashtu edhe për diasporën, të cilat aktualisht përballen me sfida politike, ekonomike dhe sociale.

Objektivat kryesorë të strategjisë, janë:

- Krijimi i një kuadri të plotë të politikbërjes mbi diasporën.

- Krijimi i një instrumenti të dobishëm në ndihmë të qeverisë dhe aktorëve të tjerë për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me diasporën dhe migracionin e ligjshëm.

- Përgatitja e administratës për nivelin e ri të marrëdhënies të politikës shtetërore me diasporën.

III. OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT

3.1 KRIJIMI I NJË KUADRI TË PLOTË TË POLITIKËBËRJES MBI DIASPORËN

I. SHTETI DHE DIASPORA

- AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës është krijuar me ligj të veçantë. Ajo është përgjegjëse për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet; ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare; nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës; bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës i Agjencisë. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen dhe shkarkohen me urdhër të ministrit përgjegjës për diasporën.

Këshilli Drejtues i Agjencisë përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme që lidhen me zbatimin e politikave për diasporën shqiptare.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për qëllim:

- Krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Zbatimin e politikave dhe projekteve që lidhen me diasporën;

- Koordinimin e diasporës me vendin e tyre të origjinës;

- Bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë;

- Ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës;

- Informimin e diasporës mbi proceset politike në vendin e origjinës;

- Përgatitjen e raporteve periodike për veprimtarinë e saj.

- FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT TË DIASPORËS

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD) ka për qëllim sigurimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare për projekte konkrete, të cilat do të vlerësohen si prioritet dhe që kanë një ndikim në përmirësimin e kushteve të jetesës. Ai do të nxisë bashkëpunimin dhe ndërveprimin nëpërmjet promovimit, inkurajimit të prirjeve filantropike dhe investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit në vend.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës (FSHZHD) do të bashkëpunojë me komunitet dhe shoqata/organizata shqiptare jashtë vendit që dëshirojnë të kanalizojnë kursimet e tyre drejt investimeve, zhvillimit të mbështetjes së projekteve për investimet e diasporës, bazuar në përvojat më të mira.

FSHZHD-ja shërben si mekanizëm i njohur nga ligji ku objektivat kryesorë, janë:

1. Mbështetja e anëtarëve të diasporës për të mundësuar kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore, shëndetësore dhe të zhvillimit rural;

2. Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse, organizata dhe individë për qëllime filantropike që veprojnë në fusha lidhur me zhvillimin social-ekonomik, kulturor, arsimor të diasporës.

- QENDRA E BOTIMEVE TË DIASPORËS

Qendra e Botimeve të Diasporës është përgjegjëse e botimit dhe shpërndarjes së teksteve mësimore të miratuara dhe literatura plotësuese të cilat do t'i shërbejnë mësimdhënies dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në komunitetet shqiptare të diasporës. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Qendrës së Botimeve të Diasporës do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

- KOMITETI SHTETËROR PËR DIASPORËN

Komiteti Shtetëror për Diasporën është organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive

shtetërore në fushën e diasporës. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrin e Brendshëm, ministrin e Financave dhe Ekonomisë, ministrin e Drejtësisë, ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministrin e Kulturës, ministrin e Mjedisit dhe Turizmit, ministrin e Shtetit për Diasporën, guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, kryetarin e Akademisë së Shkencave, drejtorin e INSTAT-it.

Fusha e veprimtarisë së Komitetit, përfshin:

a) Përgatitjen e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioriteteve strategjike në fushën e diasporës;

b) Propozimin e mekanizmave ligjore dhe institucionale për çështje që lidhen me përmirësimin e pozitës së anëtarëve të diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku jetojnë;

c) Nxitjen dhe zhvillimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjislacionit në fushën e zhvillimit të komuniteteve të diasporës;

d) Koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;

e) Mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën.

- SAMITI I DIASPORËS

Samiti i Diasporës do të kthehet në një ngjarje mbarëkombëtare duke u trajtuar si eveniment i përbashkët i pjesëtarëve më të suksesshëm e përfaqësues të diasporës. Krijimi i kësaj tradite do të fuqizojë ndjenjën e identitetit dhe bashkimit kombëtar. Ai do të rrisë respektin për diasporën dhe do të nxisë konkluzione praktike në koordinimin dhe angazhimin e saj brenda dhe jashtë vendit.

Samiti do të mbledhë figura të spikatura të biznesit, shkencës, artit, kulturës, sporteve dhe studentët e suksesshëm që jetojnë jashtë vendit. Aty do të vlerësohen arritjet dhe shkëmbehen eksperiencat në diskutimin e sfidave kombëtare dhe tejkalimin e tyre.

- KËSHILLI KOORDINATIV I DIASPORËS

Marrëdhënia e re e shtetit me diasporën do të formalizohet e institucionalizohet me ngritjen e Këshillit Koordinativ të Diasporës Shqiptare[3], i cili do të krijohet si një organizim qendror bashkëpërfaqësimi. Këshilli do të drejtojë procesin e bashkëpunimit të institucioneve shtetërore me komunitetet shqiptare jashtë vendit.

Këshilli do të jetë një strukturë ndër-institucionale për angazhimin e diasporës dhe emigrantëve dhe do të përbëhet nga partnerët kryesorë institucionalë të shtetit shqiptar dhe të diasporës.

Këshilli i Diasporës do të mbështesë krijimin e një rrjeti të organizuar të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse dhe shteteve të origjinës. Organizatat e diasporës do të përcaktojnë qëllimet e tyre, strategjitë, funksionet dhe fushat e veprimit, në pajtim me burimet e disponueshme dhe mundësitë ligjore e rregullimet institucionale në shtetet pritëse.

Rëndësia e organizimeve të diasporës është pranuar nga institucionet politike kombëtare e ndërkombëtare gjatë viteve të fundit, si Komisioni Evropian[4], Këshilli i Evropës dhe qeveritë e vendeve pritëse. Në Shtetet e Bashkuara, organizatat shqiptaro-amerikane janë falënderuar publikisht për punën e tyre prej institucioneve e politikanëve të niveleve të larta.

- DIASPORA DHE MENAXHIMI SHTETËROR

Menaxhimi i migrimit përfshin një sërë praktikash për avancimin dhe ndikimin pozitiv të diasporës shqiptare në rajonet e origjinës. Këto praktika janë të bazuara në modele të cilat do të nxisin administratën e vendeve dërguese të origjinës në krijimin e strategjive të migrimit dhe ndërtimit të kapaciteteve për aplikimin e saj.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018–2024 synon një të ardhme ku Shqipëria do të konsiderohet vend i aftë të menaxhojë rrjedhat e migrimit. Ky qëllim strategjik lidhet me zhvillimin ekonomik e social të shoqërisë dhe me imazhin e vendit.

Në këtë kontekst vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani veprimi të veçantë për nxitjen e organizimit në nivel rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse është prioritet. Në këtë drejtim do të nxitet promovimi i idesë për mbajtjen e aktiviteteve që nxisin këtë nivel organizimi nëpërmjet

[3] Këshillit Koordinativ i Diasporës Shqiptare, në vijim Këshilli i Diasporës.

[4] Komisioni Evropian i përmend në Raportin e parë Vjetor për Migracionin dhe Integrimin në vitin 2004 http://aei.pitt.edu/40065/1/com_(2004)_508.pdf

informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.

Strategjia Kombëtare vlerëson krijimin e një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës për fushën e marrëdhënieve me diasporën në funksion dhe për pasurimin e marrëveshjeve ekzistuese që ekzistojnë midis dy vendeve në këtë drejtim. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe "prodhuese" të diasporave shqiptare në botë.

Strategjia Kombëtare konsideron të dobishëm vendosjen e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e programeve për këtë qëllim (për shembull me PNUD-in për të zbatuar TOKËN në Shqipëri).

Aplikimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës do të rivlerësojë aktet ligjore ekzistuese në fushën e migracionit dhe zgjerimin e sferës së mbrojtjes së komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me qëllim përafrimin me *Acquis Communautaire*.

- SHËRBIMET KONSULLORE DHE DIPLOMACIA

Strategjia do të mbështesë rritjen e cilësisë së shërbimeve në shtetet ku janë vendosur komunitetet më të mëdha të shqiptarëve në diasporë. Krijimi i një strukture konsullatash, në pajtim me burimet financiare e njerëzore, është i nevojshëm dhe i natyrshëm.

Ambasadat shqiptare do të përgatisin raporte periodike në lidhje me gjendjen dhe organizimin e komunitetit shqiptar në shtetet pritëse. Diplomatët shqiptarë duhet të kenë njohjet e nevojshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe në politikat e migracionit, në veçanti në lidhje me konventat ndërkombëtare dhe ato dypalëshe për migracionin dhe të drejtat e migrantëve. Për të mbrojtur siç duhet të drejtat e qytetarëve shqiptarë, ambasadat dhe konsullatat shqiptare do të kenë në dispozicion të tyre ekspertë ligjorë të specializuar në të drejtat e njeriut dhe migrantëve, me njohje të plotë të rregullave e praktikave të imigracionit të vendeve pritëse.

Ambasadat, konsullatat dhe shërbimet qendrore të diplomacisë shqiptare do të disponojnë dhe ofrojnë listat e avokatëve të specializuar për të drejtën dhe çështjet e migracionit.

Informacioni bazë për komunitetin e shqiptarëve në vendin pritës do të bëhet i disponueshëm nëpërmjet faqes së internetit për çdo ambasadë dhe shërbim konsullor. Ai do të përmbajë informacionin mbi kontaktet e ambasadave e konsullatave, llojet e shërbimeve që ato ofrojnë për shtetasit shqiptarë dhe mënyrën se si të ankohen për cilësinë e dobët ose mungesën e shërbimeve.

Strategjia Kombëtare do të nxisë ndërgjegjësimin dhe orientimin e qytetarëve shqiptare jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare, nëpërmjet platformës konsullore *online*. Këtu do të përfshihet edhe dhënia e informacionit rreth organizatave joqeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

- MARRËDHËNIA E SHTETIT ME DIASPORËN

Strategjia Kombëtare mbështetet në një raport të ri cilësor të institucioneve shtetërore për diasporën sipas praktikave më të mira evropiane. Ajo do të nxisë transparencën e institucioneve në secilin aspekt të procesit të vendimmarrjes dhe efektivitetin e politikave të cilat do të sigurojnë koherencë në fushat që do të aplikohen.

Diaspora është thesari i "fshehur" i shqiptarëve, i cili duhet të tregohet dhe të shënohet. Pavarësisht dokumenteve të prodhuara nga politika shtetërore, pak veprime konkrete janë ndërmarrë për ta bërë diasporën të ndihet e mirëseardhur në zhvillimin e vendlindjes. Kur ata mundohen që të investojnë në të, shpesh, përballen me burokraci dhe korrupsion.

Strategjia vlerëson se roli i diasporës shqiptare në të ardhmen do të jetë më i fortë se sa në të kaluarën. Kjo i dedikohet edhe strukturës së saj e cila po ndryshon me një dinamikë cilësore. Nëse në të kaluarën, diaspora shqiptare ishte më pak e arsimuar dhe ka kryer punë të rëndomta, sot diaspora zotëron aftësi të cilat mungojnë në vendlindje.

Diaspora është arsimuar dhe pasuruar me kalimin e viteve dhe është e gatshme që t'u vijë në ndihmë familjeve të tyre që gjenden në vendin e prejardhjes.

Ndryshimet cilësore të diasporës do të kërkojnë vlerësimin e përqasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e

plotë të politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

- KRIJIMI I REGJISTRIT TË ORGANIZATAVE TË DIASPORËS

Regjistri i organizatave të diasporës do të jetë një informacion i rëndësishëm, i cili do të krijojë një bazë të memories shtetërore për të tashmen dhe të ardhmen. Ai do të ketë role të shumëfishta të cilat janë:

- mbështetja e së drejtës së votës;
- krijimi i rrjeteve të organizimeve profesioniste jashtë vendit;
- funksionimi si një bazë të dhënash për grumbullimin e informacionit për potencialet dhe kapacitetet e diasporës sipas profesioneve.

Strategjia Kombëtare e Diasporës synon rivlerësimin dhe zgjerimin e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Një rendësi të veçantë merr përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur, si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur.

Strategjia Kombëtarë e Diasporës synon organizimin e aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit. Ajo do të vlerësojë evidentimin e shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse, si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim merr një rëndësi të veçantë.

- NGRITJA E QENDRAVE KULTURORE SHQIPTARE

Ngritja e qendrave kulturore shqiptare në vendet pritëse të diasporës do të realizohet në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar, për të promovuar imazhin e vendlindjes e të shqiptarëve jashtë vendit dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë. Respektimi i parimit të "një diaspore" do të pasurohet nga bashkëpunimi edhe me shtete të tjera që janë prodhuese të diasporës shqiptare.

- PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË DIASPORËS

Promovimi i të drejtave të diasporës shqiptare fillon nga çështja themelore: riorganizimi i vetvetes. Ai do të bazohet në unitetin etnik dhe kombëtar shqiptar dhe nevojat e kombit në kushtet e reja ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare do të nxisë një veprim të koordinuar të qeverisë dhe institucioneve shtetërore me organizatat e diasporës shqiptare. Ajo do të nxisë politika dialogu të qarta me shtetet mikpritëse për çështje të rëndësishme, përfshirë integrimin, mësimin e gjuhës, politikat për nënshtetësinë etj.

Në shtetet mikpritëse organizatat e diasporës do të ndihmohen për të mbështetur shqiptarët që punojnë e jetojnë jashtë vendit, nevojat dhe kërkesat për informacion dhe shërbime për migrantët e rinj, pjesëmarrjen politike, të drejtat e punës, procesin e natyralizimit, të drejtat fetare apo çështje të tjera.

Diaspora ka kapacitete të cilat mund ta shndërrojnë në një faktor për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, nëpërmjet ndërmjetësimit, përcjelljes së ideve, praktikave, vlerave dhe qëndrimeve, normave të sjelljes dhe kapitalit social të tyre. Migrantët e vjetër dhe të rinj mund të luajnë një rol të rëndësishëm përmes sigurimit të ndihmës për zhvillim dhe financimit të partnerëve lokalë në këtë drejtim.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të fokusohet në mundësimin e informacioneve rreth diasporës shqiptare dhe zhvillimin e komuniteteve jashtë vendit. Në këtë kuadër do të realizohet një raport vjetor ku do të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën shqiptare.

Realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta për fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare do të jetë një prioritet. Do të organizohen trajnime periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Kjo do të shoqërohet me vlerësimin periodik të identifikimit të nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil do të marri rendësi të veçantë.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të nxis bashkëpunimin shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat janë me profile dhe trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të

drejtave të fëmijëve. Ajo do të nxisë krijimin e komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Vlerësim të veçantë do t'i kushtohet informimit publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

- POLITIKA SHTETËRORE DHE DIASPORA

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të strukturojë mekanizmat shtetërorë të politikës shtetërore për komunitetet shqiptare jashtë vendit. Kjo do të fillojë që me hartimin e manualeve praktike që lidhen me çështjet e diasporës dhe migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për diasporën.

Strategjia Kombëtare do të identifikojë aktet ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Një rëndësi të veçantë do të ketë edhe trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.

Strukturat shtetërore përgjegjëse do të vendosin kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

Në këtë kuadër do të nxitet edhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtën e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende do të vlerësohet si mekanizëm në funksion të interesit të komuniteteve shqiptare.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të kryejë rivlerësimin periodik të politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre ndaj diasporës. Në bazë të informacioneve të marra do të realizohet një raport vjetor për gjendjen konkrete të komuniteteve shqiptare, me propozime masash respektive për përmirësimin e asistencës për ta.

Strategjia Kombëtare synon krijimin e regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Vlerësimi i informacionit periodik dhe konkluzioneve për këtë çështje do të diskutohen edhe në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

Strategjia Kombëtare do të konsiderojë rishikimin e kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse do vlerësohet edhe me qëllimin për përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti.

Strategjia Kombëtare e Diasporës vlerëson dhe nxit migrimin qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë).

Rivlerësim të veçantë do të ketë në bashkëpunimin me vendet e BE-së e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfituar edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

- ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE NË DIASPORE

Organizimin e komuniteteve shqiptare në diasporë, i cili ka si qëllim:

- Krijimin e strukturës koordinative shtetërore për regjistrimin e shtetasve jashtë vendit;
- Regjistrimin e organizatave dhe inventari i aftësive të veçanta në diasporë sipas profesioneve;
- Krijimin e Rrjetit të Grave të Diasporës;
- Krijimin e rrjeteve të "Ambasadorëve të Kombit" në diasporë;
- Funksionimin e një strukture mediatike të koordinuar ndërkombëtare për diasporën.

- E DREJTA E VOTËS

Strategjia Kombëtare parashikon ndërmarrjen e një vargu hapash për ndryshime të rëndësishme në kuadrin ligjor të Shqipërisë, të cilat do të garantojë mirëpritje dhe respektim të rolit të diasporës me nënshtetësi shqiptare dhe migracionit të ligjshëm.

E drejta e votës dhe përfshirja në vendimmarrjet kombëtare do të krijojnë një hapësirë të re të protagonizmit të diasporës në shoqërinë shqiptare.

Përfshirja e diasporës në sistemin politik dhe zgjedhor është e rëndësishme pasi mundëson përfshirjen e kontributin dhe ekspertizën e saj në administrimin e shtetit. Gjeneratat e reja të diasporës kanë nivele arsimore të admirueshme për administrimin shtetëror. Ekspertiza e diasporës do të kërkohet edhe në fushat e tjera të shkencës, teknologjisë dhe zhvillimit të Shqipërisë.

- NËNKOMISIONI PARLAMENTAR PËR DIASPORËN DHE MIGRACIONIN

Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin vepron në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe është përgjegjës për propozimin, shqyrtimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave shtetërore për diasporën dhe migracionin. Ai do të shërbejë edhe si krijues i kohezionit politik në Kuvend në çështjet të cilat kanë të bëjnë me diasporën.

- DIPLOMACIA PUBLIKE E DIASPORËS

Vlerësimi i arritjeve të diasporës do të inkurajojë pjesëtarët e saj më të njohur që të punojnë si "Diplomatë Publikë" të shtetit jashtë vendit. Diplomacia publike ka të bëjë me ndikimin e qëndrimeve dhe opinioneve në formimin dhe zbatimin e politikave të shteteve pritëse. Ajo përmban dimensione të marrëdhënieve ndërkombëtare përtej diplomacisë tradicionale dhe kultivim të opinionit publik në shtetet e tjera.

Protagonistët e shoqërive ku jetojnë anëtarët e diasporës, aktorët, këngëtarët, sportistët dhe biznesmenët, të cilët kanë influencë, njohje të drejtpërdrejtë me mediat, miq nëpër rrjetet sociale dhe që krijojnë influencë në publik do të bëhen natyrshëm "ambasadorët" më të mirë për kultivimin e imazhit pozitiv për kombin shqiptar.

Strategjia Kombëtare do të kërkojë angazhimin e institucioneve shtetërore i cili përfshin edhe përkrahjen e aktivitetit të diasporës kur ajo adreson një situatë të caktuar në shtetin pranues. Kjo do të përfshijë edhe aktivizimin e institucioneve politike në shtetin e prejardhjes që të veprohet në favor të migrantëve karshi autoriteteve në shtetin mikpritës.

Organizimet gjithëpërfshirëse të migrantëve do të kenë qendra të kulturës dhe informacioni, të cilat do të financohen nga autoritetet e shtetit ose në bashkëpunim me shtetin pritës dhe donatorë të interesuar. Qendrat e kulturës do të angazhohen në shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar në diasporë.

2.3.2 KRIJIMI I NJË INSTRUMENTI TË DOBISHËM NË NDIHMË TË QEVERISË DHE AKTORËVE TË TJERË PËR TË PËRMIRËSUAR DHE FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN ME DIASPORËN DHE MIGRACIONIN E LIGJSHËM

1. PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË EKONOMINË KOMBËTARE

- REMITANCAT - NGA KONSUMI DREJT ZHVILLIMIT

Dërgesat në para të migrantëve kanë ndihmuar kryesisht në konsumin e përditshëm dhe mbijetesën ekonomike të familjeve shqiptare. Ato kanë plotësuar nevojat themelore të jetesës për ushqim, veshmbathje, shpenzime për kujdes shëndetësor, arsimim të fëmijëve apo për ndërtimin dhe mobilimin e shtëpive. Studimet tregojnë se një vit qëndrim në emigracion i një pjesëtari të familjes, sjell një rritje prej 5 për qind të konsumit për familjen e tij. Por, këto dërgesa nuk kanë ndikuar sa duhet në zhvillimin ekonomik të vendit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Varësia e ekonomisë shqiptare nga remitancat është e ndjeshme. Ato kanë përbërë 9–15 për qind të GDP-së dhe rreth 15 për qind të të ardhurave familjare. (Në një kohë që India, si pritësi më i madh i remitancave në botë, përfiton rreth 20 EUR për frymë dhe më pak 1 për qind të GDP-së.) Shqipëria renditet ndër vendet me shkallë varësie të lartë nga remitancat.

Fig. 6. Dinamika e remitancave të migrantëve shqiptarë, 2002–2016



Burimi: Open Data Albania, 2016 & Banka e Shqipërisë, 2016

Dinamika e remitancave në vend është zhvilluar në tri faza:

1. Faza e rritjes, 1991–2007;
2. Faza e rënies, 2008–2013;
3. Faza e ringritjes, prej vitit 2014.

Remitancat erdhën duke u rritur nga viti 1991 në vitin 2007, kur arritën në maksimumin e tyre. Në këtë vit në Shqipëri hynë në formë remitancash 952 milionë euro dhe ishte vendi me varësinë më të madhe nga remitancat në rajon, me mbi 300 euro për frymë. Pas këtij viti remitancat erdhën në rënie, duke arritur pikën më të ulët në vitin 2013, nën nivelin 500 milionë euro. Pakësimi i remitancave shkaktoi rritje të varfërisë. Remitancat filluan të rriten në vitin 2014, duke arritur në 592 milionë euro dhe në vitin 2016 arritën në 616 milionë euro.[5]

Fig. 7. Ecuria e remitancave në vitet 1993–2016



Burimi: Banka e Shqipërisë
(Shifrat janë të konvertuara në USD dhe për pasojë kanë edhe një impakt nga kursi i këmbimit të USD-së me valutat e tjera.)

[5] http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/1074/Remitancat-si-flukse-hyrese-dhe-dalese-2016

Rënia e remitancave drejt Shqipërisë ndodhi kryesisht për shkak të krizës ekonomike në vendet kryesore pritëse si Greqia dhe Italia. Por, vlen të shtohen shkaqe të tjera si maturimi i procesit migrator, mplakja e brezit të parë të migrantëve, rritja e shpenzimeve për brezin e dytë dhe të tretë të emigrantëve, kristalizimi i projekteve migratore, rritja e kostos së shërbimeve publike dhe jetesës në vendet pritëse, modifikimi i sjelljes dhe projekteve individuale e familjare për shkak të pasigurisë e ankthit që shkakton kriza financiare etj.

Strategjia Kombëtare vlerëson se varësia e lartë nga remitancat bën të nevojshme administrimin strategjik të tyre. Shmangia nga ky proces rrit rrezikun e pasojave të administrimit të dobët. Ky i fundit shfaqet sidomos në mungesën e bashkëveprimit në ekonomi midis remitancave dhe burimeve të tjera të zhvillimit si investimet e huaja direkte dhe tregtia.

Kanalet kryesore të dërgimit të parave prej emigrantëve shqiptarë familjeve të tyre fillimisht kanë qenë informale. Ato janë sjellë pranë familjes nga të interesuarit ose dërgimit përmes të afërmve e miqve. Në një fazë të mëvonshme filloi dërgimi i tyre i formalizuar nëpërmjet korrierëve të paguar dhe institucioneve jobankare. Në fazën e tretë ka nisur edhe dërgimi i tyre nëpërmjet sistemit bankar.

Sistemi bankar është shfrytëzuar fillimisht pak për dërgesat e emigrantëve. Kjo ka ndodhur për arsye historike, psikologjike e praktike. Ndër arsyet kryesore renditen kultura bankare e kufizuar, produktet bankare të pakta, kostot e larta të transfertave dhe besimi i ulët te bankat sidomos e zhvilluar kjo për banorët e zonave rurale në vend. Institucionet jobankare, si Western Union, i cili në vitin 2005 zotëronte rreth 80% të tregut të remitancave, kanë mbizotëruar për shkak të besueshmërisë, shpejtësisë, mungesës së burokracisë dhe fleksibilitetit e orarit të zgjatur me të cilën ato punonin.

Kanalizimi i remitancave drejt mekanizmave formalë rrit transparencën dhe promovon sistemin bankar vendas duke rritur fuqinë e tregut të remitancave. Strategjia Kombëtare parashikon që në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve pritëse për remitancat të promovojë transfertat me kosto më të ulët përmes kanaleve formale.

Remitancat e migrantëve do të konsiderohen një prej instrumenteve të zhvillimit të vendit. Strategjia Kombëtare e Diasporës parashikon një koordinim kombëtar të institucioneve përgjegjëse shtetërore për të bashkëvepruar për të krijuar një plan veprimi për remitancat, i cili do të:

- Evidentojë praktika të mira për dërgesat e emigrantëve,
- Zgjerojë shërbimet bankare në Shqipëri dhe përmirësojë bashkëpunimit mes bankave shqiptare e të huaja në lidhje me remitancat,
- Zgjerojë kapacitetet e institucioneve të tjera financiare dhe të Postës Shqiptare për të përmirësuar shërbimin e transferimit të remitencave,
- Rrisë kapacitetet shtetërore dhe të organizatave të diasporës në vendet pritëse për të bashkëpunuar në zhvillimin e përbashkët të iniciativave mes këtyre vendeve.
- Nxisë kanalizimin e remitancave në rrugë bankare dhe ndërmarrjen e hapave praktik në përdorimin e remitancave për zhvillim të vendit.

Strategjia Kombëtare do të nxisë aftësimin e familjeve të migrantëve si pritës të remitancave për përdorimin më eficient të tyre dhe menaxhimin e bizneseve të vogla. Krijimi i shembujve të cilat i tregojnë diasporës sesi familjarët e tyre do t'ua kthejnë paratë e marra do të jetë një nxitje për ajo që të risë dërgesat në para për familjet në Shqipëri.

- DIASPORA - KONTRIBUESE E ZHVILLIMIT TË SHQIPËRISË

Strategjia Kombëtare inkurajon pjesëmarrjen e diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo nxit thithjen e investimeve nga diaspora, themelimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme, përfshirë ato në fushën e bujqësisë, industrisë ushqimore dhe zhvillimin e zonave rurale.

Strategjia Kombëtare do të krijojë një ambient të favorshëm në vendlindje për diasporën siç janë incentivat fiskalë, shtimin e informacionit, shmangien e korrupsionit, reduktimin e riskut, shmangien nga tatimet e importimit për makineritë, pajisjet dhe lëndët e para për investime, heqjen e tatimit të korporatës dhe zvogëlimin e numrit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit.

Strategjia Kombëtare nxit promovimin e produkteve specifike bankare për diasporën dhe

përkrah krijimin e politikave bankare të veçanta (apo krijimin e Bankës për Diasporën). Ajo inkurajon sistemin bankar të ndërmarrë një reformë për sa u përket normave të interesit, të cilat do të nxisin diasporën të shkojë një hap më larg se sa transferimi i pagesave në vendin e origjinës. Fondet e depozituara nga migrantët mund të përdoren për dhënien e kredive lokale. Kursimet e diasporës mund të kthehen në kredi më të lira, të cilat do të përkrahin bizneset vendore.

Strategjia Kombëtare nxit krijimin e një platforme, e cila do të ofrojë fonde për mikrokredi për diasporën dhe migrantët. Kjo mund të bëhet edhe përmes institucioneve ekzistuese mikrofinanciare. Do të aplikohen edhe modelet e ofrimit të kredive për aktivitete të vogla gjeneruese të të ardhurave për individë dhe për zhvillimin e bizneseve në emër të grupeve të organizuara. Shoqatat lokale mund të transformohen në kooperativa ekonomike, përmes qasjes në kredi të financuara nga diaspora, si dhe ndihmës teknike që ofrohet nga projektet. Potenciali zhvillimor i ofertës qëndron në kapacitetin e saj për të ulur koston e kredive për të dobëtit që marrin mikrokredi. Në këtë rast, aktivitetet fundore që përfitojnë nga kreditë mund të mos kenë parashikime për angazhimin direkt të diasporës. Brenda kontekstit, diaspora mund të preferojë kanalizimin e fondeve drejt bizneseve të një kreditori të panjohur e jo një të afërmi me lidhje familjare, pasi kjo rrit mundësinë e kthimit të kredisë. Pagesat për familjen apo miqtë mund t'i ekspozohen rrezikut që të kuptohen më shumë si "dhurata" e jo si huamarrje.

Investimet e diasporës do të orientohen drejt bizneseve kolektive, të cilat do të vlerësohen me rëndësi për komunitetet e diasporës. Në këto raste, migrantët do të kenë pjesën e tyre të drejtpërdrejtë në biznese. Kjo do të bëhet përmes përkrahjes ndaj iniciativave kolektive apo bizneseve private, për shembull, duke zgjedhur një sektor të caktuar ekonomik me rëndësi më të madhe për komunitetet lokale. Për migrantët që dëshirojnë të kthehen në Shqipëri, fuqizimi i bizneseve të qëndrueshme e bën këtë mundësi më tërheqëse, ose jep mundësinë që gjenerata e dytë apo e tretë të kalojë më shumë kohë në vendin e origjinës.

Diaspora do të inkurajohet të marrë pjesë me përparësi në projekte të partneritetit publik-privat dhe të investojnë në projekte infrastrukturore.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të nxisë në koordinimin dhe organizimin e takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë" në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor, si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.

- RRJETET E DIASPORËS

Krijimi i rrjeteve funksionale të biznesit të diasporës do të rrisë interesimin e investuesve nga diaspora. Këto rrjete sipërmarrjeje do të kontribuojnë në politikat zhvillimore dhe planet strategjike për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Për të nxitur themelimin e rrjeteve të bizneseve, do të krijohet Regjistri i Bizneseve të Diasporës.

Strategjia parashikon krijimin e një forumi të pavarur të ekspertëve nga diaspora dhe ekspertëve në Shqipëri, për të nxitur dhe orientuar sipërmarrjet dhe investimet e diasporës në ekonominë e vendit. Mundësia e krijimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës do të profilizonte interesat dhe krijonte një mekanizëm bashkëpunimi në fushën e investimeve.

Strategjia Kombëtare parashikon rritjen e kapaciteteve profesionale për dhënien e shërbimeve mbështetëse lidhur me mundësitë e investimeve në Shqipëri (mjedisi i biznesit, ndryshimet ligjore etj.), duke shërbyer si ndërlidhje e investitorëve nga diaspora me komunitetin e biznesit në vendlindje.

Tërheqja e investimeve të diasporës do të ketë nevojë për një mentalitet të ndryshuar të administratës publike. Mekanizmat fillestarë të veprimit të Strategjisë konsiderohen vendimtarë për procesin që nxit ajo.

Strategjia Kombëtare e Diasporës në këtë drejtim do të nxisë edhe organizimin dhe administrimin e një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikat e diasporës dhe migracionit.

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikat kombëtare mbi diasporën do të jetë një prioritet.

Në këtë kuadër do të konsiderohet krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekteve stimuluese dhe aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

Një synim i Strategjisë Kombëtare do të jetë organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse, si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të konsiderojë cilësinë e faqeve të internetit të institucioneve shtetërorë për informacionin të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Në këtë kuadër pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare janë edhe realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me "kujdestarët" e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

Qëllim i rëndësishëm i Strategjisë Kombëtare është organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve "homologe" në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre do të jetë një prioritet i veçantë.

Në funksion të ndërtimit të rrjeteve funksionale të diasporës do të jetë edhe planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi:

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë;
- Ekzistencën e burimeve informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend.

Qëllimi i procesit do të jetë që diaspora dhe migracionit të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

Në këtë drejtim rëndësi merr krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe *internship*-it, të universiteteve shqiptare me universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

Rëndësi merr realizimi i një plani të veprimit mediatik për nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për të siguruar eksplorimin e gjithë potencialit të saj dhe shfrytëzimin e të gjithë avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi.

Do të vlerësohet përgatitja nga institucionet përgjegjëse të turizmit e një fushate promocionale, për të tërhequr vëmendjen e atij segmenti të diasporës që është në kërkim të rrënjëve, kulturës dhe traditave të paraardhësve. Në bashkëpunim me sektorin privat do të përgatitet një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe. Si ikona të kësaj fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg.

Një nga qëllimet e rëndësisë së veçantë të Strategjisë Kombëtare të Diasporës është nxitja e organizimeve të Rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Në funksion të këtij qëllimi do të jetë organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës.

Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim është pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë.

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit "Ambasador i Kombit". Krijimi i rrjetit të ambasadorëve të kombit (formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje) është një cilësi e organizimit të rrjeteve në diasporë. Protagonizmi dhe suksesi do të ndërlidhen në funksion të organizimit shqiptar në diasporë.

- INSTRUMENTE TË DOBISHME

Strategjia Kombëtare e Diasporës ka qëllim mbështetjen e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.

Strategjia Kombëtare do të vlerësojë negocimin për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. Në këtë kuadër do të kryhet vlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë.

Strategjia Kombëtare e Diasporës do të realizojë kryerjen e fushatave sensibilizuese lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse, si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:

- Publikim i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,
- Botimi në gazetat shqiptare jashtë vendit,
- Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,
- Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit.

Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë. Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:

- Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve;
- Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës;
- European Court in Human rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut;
- European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe - Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës;
- Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të Parlamentit Evropian;

Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së.

3.3 PËRGATITJA E ADMINISTRATËS PËR NIVELIN E RI TË MARRËDHËNIES TË POLITIKËS SHTETËRORE ME DIASPORËN

1. KOMUNITETET SHQIPTARE JASHTË VENDIT DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Përfshirjen e komuniteteve shqiptare në diasporë në zhvillimin ekonomik të vendit i cili do të fokusohet në:

- Krijimin e një skeme të koordinimit të rrjeteve profesionale të diasporës;
- Krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës;
- Organizimin e propozimeve motivuese ligjore për investimet e diasporës.

Plani i Veprimit do të fokusohet edhe në zbatimin e marrëveshjeve bilaterale të Shqipërisë me Kosovën për koordinimin midis dy shteteve në bashkëveprimin me diasporën shqiptare. Një vend të rëndësishëm merr edhe realizimi i një plan-veprimi të përbashkët institucional me zyrën e IOM-it në Tiranë.

3.3.2 MBROJTJA E IDENTITETIT DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

- KAPITALI HUMAN, SOCIAL DHE KULTUROR

Diaspora shqiptare ka të grumbulluar një kapital të konsiderueshëm jomonetar, në formën e kapitalit human, social dhe kulturor.

Kapitali human lidhet me njohuritë e shprehitë profesionale dhe kulturën e punës që kanë fituar migrantët gjatë punës, studimit dhe jetesës në vendet pritëse.

Kapitali social ka të bëjë me vlerat sociale që fitojnë migrantët gjatë qëndrimit në vendin pritës.

Kapitali kulturor vlerëson vlerat kulturore që fitojnë migrantët, të cilat shërbejnë për të forcuar bashkëjetesën kulturore midis vendeve pritëse

dhe dërguese. Këto vlera janë në bashkëveprim me promovimin e kulturës shqiptare në vendet pritëse, nëpërmjet diplomacisë kulturore.

Diaspora mund të kontribuojë jo vetëm nëpërmjet kthimit fizik në Shqipëri ose dërgimit të kapitaleve financiare, por edhe nëpërmjet kapitaleve të përmendura më sipër, si dhe njohuritë e aftësitë teknike, "dërgesat teknologjike" etj.

Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina kanë potencial të konsiderueshëm intelektualësh shqiptarë që jetojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri nën kujdesin shtetëror do të ofrojë më shumë informacion mbi profilet profesionale të diasporës në fusha të ndryshme, si biznesi, shkenca, teknologjia, shëndetësia, turizmi etj. Strategjia Kombëtare do të nxisë praktikën e "ftesave të hapura" për projekte që duhen promovuar ndaj diasporës. Për këtë qëllim Fondi për Zhvillimin e Diasporës do të inkurajojë profesionistët nga diaspora që të aplikojnë në projekte të ndryshme, duke mundësuar kështu bartjen e njohurive dhe përvojave më të mira.

Strategjia rivlerëson bashkëpunimin me donatorët në këtë drejtim në programe të modelit *Brain Gain* (Kthimi i Trurit) në krijimin e strukturave institucionale që mundësojnë kthimin e profesionistëve të talentuar, si dhe parandalimin e largimit të personave që janë diplomuar jashtë vendit.

Për këtë qëllim do të rivlerësohet programi i themeluar më 2008, i cili ofroi përkrahje financiare për të kualifikuarit që i fton të kthehen të punojnë në Shqipëri. Ai ndërtoi një bazë të dhënash me studentë dhe akademikë jashtë vendit, si dhe ka shtyrë mbi 150 profesionistë që të kthehen në vendlindje. Ai, gjithashtu, planifikon të themelojë rrjete kontaktesh me ata që ende janë jashtë. Ky program mbështet universitetet dhe administratën publike në punësimin në pozicionet drejtuese dhe akademike individë të kualifikuar jashtë vendit, të përzgjedhur në baza konkurruese dhe transparente.

Kthimi i individëve me një kualifikim të lartë është pjesë e Strategjisë Kombëtare në mënyrë që të përfshijë diasporën shqiptare në zhvillimin ekonomik, shkencor dhe administrativ të vendit. Kjo përfshin edhe analizën kritike të ligjeve e praktikave aktuale në administratën publike që promovojnë tërheqjen e atyre që janë diplomuar jashtë vendit.

- RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR

Diaspora shqiptare ka një kontribut të padiskutueshëm në historinë dhe identitetin kombëtar.

Identiteti i diasporës është një konstrukt shoqëror që zhvillohet përgjatë kohës. Në rastin e diasporës shqiptare ky proces i ndërtimit të identitetit është i bazuar në një kuptim të përbashkët të historisë, kujtimeve të riprodhuara dhe të rikujtuara, padrejtësive lidhur me ndarjen e territoreve të banuara me shqiptarë, viktimizimin dhe valët e dhunshme të migrimit etj. Edhe sikur të gjithë migrantët shqiptarë të mos braktisnin vendlindjet e tyre për arsyet e lartpërmendura, këto trauma të përbashkëta historike i bashkojnë kur ata gjenden në vendet mikpritëse dhe kështu fitojnë ndjenjën që bashkërisht përbëjnë "një diasporë".

Boshti kryesor i kombit shqiptar ka qenë dhe mbetet familja. Shumica e aktiviteteve të tij përkufizohen me këtë koncept. Diaspora shqiptare dhe organizimi i saj ka të bëj shumë me "familjen", marrëdhëniet familjare dhe lidhjet me vendlindjen. Ajo është një diasporë etno-nacionale. Historia dhe gjuha e përbashkët, mitet dhe legjendat, ushqimi, kostumet dhe folklori krijojnë dhe ruajnë identitetin e diasporave etno-sociale shqiptare.

Kultura e lidhjeve të ngushta të familjeve shqiptare konsiderohet të jetë një ndër përparësitë kryesore të diasporës shqiptare.

Në vitet e hershme të pavarësisë së Shqipërisë roli i pjesëtarëve të mirë arsimuar të diasporës ishte i rëndësishëm si në administrimin e shtetit, ashtu edhe në negociatat ndërkombëtare për statusin e saj.

Shoqata të ndryshme në botë si "Vatra" shtypën tekstet shkollore, të cilat pastaj dërgoheshin në Shqipëri. Shqiptarët e Amerikës, gjithashtu, ishin protagonistë në vendosjen e marrëdhënieve të veçanta politike dhe tregtare mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë. Nga komunitetet në diasporë u krijuan lobime pranë qeverive të vendeve pritëse në përkrahje të vendlindjes dhe mjaft figura të saj u bënë autoritete të politikës e përfaqësues të shtetit shqiptar.

Strategjia parashikon rritjen e kontributit të diasporës dhe bashkëpunimit të qeverisë dhe institucioneve të shtetit shqiptar me të për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve.

Qendrat e Kulturës në Diasporë si produkt i marrëveshjes shtetërore midis Shqipërisë dhe Kosovës do të jenë "infrastruktura" e qëllimit të ruajtjes së identitetit kombëtar në diasporë.

- ARSIMIMI, EDUKIMI DHE MEDIA

Diaspora shqiptare, me karakteristikat dhe traditat e përbashkëta kulturore, nxit brezat e rinj të ruajnë identitetin kombëtar dhe të mbesin si pjesëtarë të diasporës, edhe pse jetojnë në shoqëritë pritëse dhe kanë identitet të dyfishtë, ose shtetësi të dyfishtë.

Strategjia Kombëtare i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes së identitetit kulturor, gjuhësor dhe kombëtar të diasporës. Kjo do të arrihet vetëm në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë mes diasporës dhe Shqipërisë si vend origjine. Angazhimi me projekte të veçanta të programeve edukative dhe kulturore do të pengojë asimilimin e mëtejshëm në aspektin gjuhësor, veçanërisht i brezave të dytë dhe të tretë në diasporë. Këtu do të përfshihen kurset e gjuhës shqipe dhe mësimdhënësit që punojnë në shkolla me orë plotësuese. Strategjia parashikon marrëveshje të veçanta me institucionet e shtetit të Kosovës në këtë drejtim. Administratat përgjegjëse të Shqipërisë dhe Kosovës do të bashkëpunojnë për të krijuar politika e programe edukuese që do të mirëpriten nga gjeneratat e reja. Krijimi i një tradite të modelit të "*summer school*" - shkollave verore do të jetë një mjet i cili do të kthehet në traditë edukuese për fëmijët e diasporës.

Strategjia Kombëtare vlerëson rolin e mediave audiovizive dhe medias sociale në ruajtjen e gjuhës. Transmetuesit publikë do të jenë ligjërisht të detyruar t'i dedikojnë 10 deri 15 për qind të programit (tokësor dhe satelitor) tematikës së diasporës dhe migracionit.

Strategjia Kombëtare i kushton vëmendje mediave sociale. Ato po kthehen në një revolucion i mjeteve të ndërveprimit mes njerëzve, me të cilat po krijojnë, shkëmbejnë dhe ndajnë informacion e ide në komunitete dhe rrjete virtuale. Media sociale në diasporë ka krijuar një realitet të ri të një opinioni "publik" të komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

IV. KOSTIMI DHE BUXHETIMI

Strategjia Kombëtare për Diasporën, do të zbatohet në periudhën 2018–2024.

Duke marr në konsideratë faktin e krijimit për herë të parë në një strukturë qeverie të ministrit të Shtetit për Diasporën, për të mundësuar zbatimin e strategjisë janë parashikuar fillimisht vetëm kostot paraprake për vitin 2018.

Në Planin e veprimit për periudhën 2018–2024, janë evidentuar masat dhe kostot përkatëse, të cilat do të zbatohen gjatë vitit 2018.

Financimet e këtyre masave multidisiplinore do të mbulohen kryesisht nga programet buxhetore të institucioneve zbatuese të kësaj Strategjie Kombëtarë. Kostot fillestare administrative e përllogaritura për vitin 2018 do të jetë në masën 130.000.000 lekë:

- Agjencia Kombëtare e Diasporës 60 milionë lekë;
- Fondi për Zhvillimin e Diasporës 50 milionë lekë;
- Qendra e Botimeve për Diasporën 20 milionë lekë.

Ato kanë të bëjnë kryesisht me vendosjen në funksionim administrativ të këtyre strukturave të reja shtetërore. Kjo përllogaritje është në përputhje me ligjin nr. 115, datë 28.12.2017, si edhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kostot e tjera do të përballohen nga buxheti i shtetit të institucioneve përgjegjëse, si edhe nga donatorët.

Një grup pune i posaçëm specialistësh nën drejtimin e zyrës së ministrit të Shtetit për Diasporën do të krijohet për përcaktimin dhe detajimin e kostove të planit të veprimit për periudhën 2019–2024. Ai do të përbëhet me përfaqësues nga të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit, të cilat implikohen për zbatimin e planit të veprimit. Afati për finalizimin e planit të veprimit për periudhën 2019–2024 do të jetë brenda një viti nga miratimi i kësaj strategjie. Grupi i punës do të ngrihet pas hyrjes në fuqi të vendimit për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018–2024 dhe Planit të Veprimit.

Për llogaritjen fillestare të shpenzimeve për aktivitetet kryesore të cilat do të përballohen nga buxheti i shtetit dhe donatorët është vepruar, si më poshtë:

- Llogaritja e shpenzimeve për burime njerëzore bazohet në kohën e parashikuar për realizimin e veprimtarive dhe një pagë mesatare ditore të një kategorie të caktuar të nëpunësve civilë;

- Llogaritja e shpenzimeve për shërbime është bërë duke mbajtur parasysh kostot e shërbimeve të institucioneve përkatëse, bazuar në standardet e miratuara;

- Llogaritja e shpenzimeve për aktivitete që lidhen me hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme etj. Është bërë duke mbajtur parasysh shpenzimet e vazhdueshme që do të ndodhin, për shembull: për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore, ekspertizë të huaj (kur është parashikuar në plan) dhe mjete konsumi.

- Llogaritja e shpenzimeve për "aktiviteteve specifike" ose i iniciativave specifike të ngjashme u bazua kryesisht në natyrën e aktiviteteve dhe kostot që ofron tregu për shërbime të tilla.

Në llogaritjen e shpenzimeve për trajnime është mbajtur në konsideratë kosto e trajnimit për një person. Si kosto për njësi janë përdorur kostot e ASPAs dhe/ose kostot e aplikuara për trajnime të ngjashme në të shkuarën.

Për atë pjesë të aktiviteteve ku informacioni nuk është i plotë është ndjekur metoda e vlerësimit për analogji, ose janë marrë në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme që kanë qenë përfshirë në strategjinë e viteve 2011–2015, ose produkte të ngjashme në PBA.

Konkluzionet edhe në fushën e buxhetimit për Strategjinë Kombëtare 2018–2024 dhe Planin e Veprimit, do të dalin nga Komiteti Shtetëror i Diasporës, i cili është ngritur me vendimin nr. 690, datë 27.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën".

V. MONITORIMI DHE ZBATIMI

1. MONITORIMI

Strategjia Kombëtare është një dokument politik parashikues. Por publiku duhet të jetë në dijeni për pasiguritë dhe rreziqet e zbatimit të saj. Parashikimi mund të luajë rol në realizimin e sfidave të botës aktuale duke e ofruar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit si një mundësi ndryshimi.

Pjesëtarët e diasporës shqiptare janë të interesuar për gjendjen politike dhe ekonomike të shtetit të tyre dhe me siguri do ta vazhdojnë këtë interesim edhe në të ardhmen.

Një skenar negativ do të ishte që diaspora të ndjehej e neglizhuar dhe e ndarë prej zhvillimeve në shtetin e prejardhjes dhe kështu do të ishte më pak e interesuar lidhur me gjendjen dhe pak e gatshme që të bënte diçka për të. Kjo do t'i hapte rrugën asimilimit të ngadalshëm të saj.

Një skenar pozitiv dhe i dëshirueshëm do t'i përfshinte pjesëtarët e diasporës që të ishin më afër zhvillimeve politike dhe ekonomike të shteteve të prejardhjes, ku ata do të ndiheshin të respektuar, të mirëpritur dhe do të shihnin përparësi të qarta nga përfshirja e tyre në zhvillimin e vendit të origjinës ndonëse jetojnë jashtë vendit.

Struktura monitoruese për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën do të koordinohet nga ministri i Shtetit për Diasporën.

Për raportin vjetor do të ngrihet një grup pune i cili do të kryesohet nga përfaqësuesi i ministrit të Shtetit për Diasporën dhe do të ketë në përbërje përfaqësues të Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare për Diasporën. Raporti do të paraqitet për miratim te ministri i Shtetit për Diasporën.

Pas monitorimit dhe zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme, do të raportojnë, pranë:

- Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin i cili do funksionojë në përbërje të Komisionit të Politikës së Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë,

- Komiteti Shtetëror për Diasporën, i cili do të drejtohet nga Kryeministri.

- Monitorimi i zbatimit të dokumentit të Strategjisë Kombëtare vlen edhe në shmangien e çdo skenari negativ. Ky proces do të ritheksojë të vërtetën e thjeshtë se shqiptarët kudoqofshin janë pjesë e kombit.

Një komb i cili të veçantën e tij e ngre në nivelin e virtytit, bën paqe me veten dhe të ardhmen. Koha punon për kombin që vepron.

PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

2018–2024

Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës do të nxisë synimet e veprimtarisë së politikës shtetërore të Shqipërisë ndaj komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

Zhvillimin institucional dhe drejtues të strukturës shtetërore përgjegjëse për diasporën i cili përfaqësohet nga:

- Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë;
- Komiteti Shtetëror për Diasporën;
- Ministri i Shtetit për Diasporën;
- Këshillit Koordinativ i Diasporës;
- Agjencia Kombëtare e Diasporës;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës;
- Qendra e Botimeve për Diasporën.

Strategjia Kombëtare e Diasporës është komplekse dhe shumë sektoriale, e cila çelësin e suksesit të ndërhyrjes së saj do ta jetë në koordinimin midis institucioneve të shtetit shqiptar dhe këtyre të fundit me strukturat organizative të diasporës dhe shoqërisë civile.

Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Diasporës parashikon masa konkrete, të cilat do të duhet të zbatohen kryesisht nga qeveria shqiptare, por edhe nga aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Shumica e masave të parashikuara në Planin e Veprimit parashikojnë aktivitete dhe veprime, të cilat do të duhet të realizohen brenda afateve të përcaktuara. Për shumicën e tyre kërkohet ndërhyrja e koordinuar e më shumë se një institucioni shtetëror.

Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare do të jetë pjesë e veprimtarisë të institucioneve shtetërore të Shqipërisë me qëllim garantimin e zbatimit të saj. Dokumenti do të shoqërohet me masa të detajuara dhe elementët e nevojshëm për vënien në jetë të tyre. Ai do të jetë fryt i bashkëpunimit të një numri të madh ministrish dhe institucionesh, të cilët do të përfshihen në përpunimin e politikës së re në këtë fushë të veprimit shtetëror.

Diaspora dhe politika ndaj saj e ka një të ardhme ku vlerësimi lidhet me veprimin.

KRIJIMI I NJË KUADRI TË PLOTË TË POLITIKËBËRJES MBI DIASPORËN

SHTETI DHE DIASPORA

Masa 1

Bërja funksionale e institucioneve që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën siç janë Agjencia Kombëtare për Diasporën, Fondi për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën. Hartimi i një plani të detajuar për përthithjen e fondeve të nevojshme për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare. Ndarja e qartë e kompetencave midis strukturave që do të merren me trajtimin e diasporës. Krijimi i një njësie të specializuar për rishikimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.

INDIKATORËT: Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Diasporën, Fondi për Zhvillimin e Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Zëvendëskryeministri

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria i Financave dhe Ekonomisë

Masa 2

Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin.

INDIKATORËT: Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor për diasporën.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Kulturës

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 3

Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2024.

INDIKATORËT: Procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës).

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës
Ministri i Shtetit për Diasporën

Masa 4

Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të Diasporës si ngjarja e më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare, me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të shqyrtohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet në Shqipëri.

INDIKATORËT: Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Samitit të dytë të Diasporës. Organizimi periodik i Samitit të Diasporës Shqiptare.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2018-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministra e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 5

Krijimi i Këshillit Koordinativ të Diasporës si një strukturë koordinative për të punuar për forcimin organizativ të e komuniteteve shqiptare me qëllim përfshirjen dhe partneritetin në zhvillimin e Shqipërisë.

INDIKATORËT: Krijimi i Këshillit Koordinativ të Diasporës si një strukturë koordinative.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 6

Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe përgatitja e një plani veprimi të veçantë për nxitjen e organizimit në nivel rajonal dhe shtetëror në vendet pritëse. Promovimi i idesë për mbajtjen e aktiviteteve që nxisin këtë nivel organizimi nëpërmjet informimit të komunitetit shqiptar dhe identifikimit të burimeve njerëzore.

INDIKATORËT: Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë. Promovimi i idesë.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës

Masa 7

Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës për fushën e marrëdhënieve me diasporën në funksion dhe për pasurimin e marrëveshjeve ekzistuese që ekzistojnë midis dy vendeve në këtë drejtim. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve të nevojshme në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe "prodhuese" të diasporave shqiptare në botë.

INDIKATORËT: Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministri i Shtetit për Diasporën

Masa 8

Vendosja e bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e programeve për këtë qëllim (për shembull me PNUD-in për të zbatuar TOKËN në Shqipëri).

INDIKATORËT: Bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

Masa 9

Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit zgjerimin e sferës së mbrojtjes së komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me qëllim përafrimin me Acquis Communautaire.

Realizimi i procedurave për përfundimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare (nëse nuk janë realizuar ende) si më poshtë:

Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 143, "Për punonjësit migrantë".

Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës "Mbi statusin ligjor të punonjësve migrantë".

Ratifikimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara, "Për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punonjësve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre".

INDIKATORËT: Rivlerësimi i akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit. Realizimi i procedurave për ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Drejtësisë

Masa 10

Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor në vendet me një prezence të qenësishme të komuniteteve shqiptare dhe të një rëndësie të veçantë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve diplomatike dhe ekonomike të vendit pritës me vendin e origjinës. Orientimi i planit të punës së trupës diplomatike dhe konsullore me një fokus të veçantë drejt marrëdhënieve me komunitete shqiptare jashtë vendit.

INDIKATORËT: Vlerësimi i një pranie të re përfaqësimi diplomatik ose konsullor.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

Masa 11

Ndërgjegjësimi dhe orientimi i qytetarëve shqiptare jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare, nëpërmjet platformës konsullore online. Dhënia e informacionit rreth organizatave joqeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

INDIKATORËT: Orientimi i qytetarëve shqiptare jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 12

Vlerësimi i përqasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

INDIKATORËT: Përqasja e strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Zëvendëskryeministri
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 13

Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur, si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur.

Organizimi i aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit.

INDIKATORËT: Zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët. Përcaktimi i përgjegjësive dhe organizimi i aktiviteteve jashtë vendit.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Zëvendëskryeministri
Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Brendshëm
Ministri i Shtetit për Diasporën

Masa 14

Ngritja e qendrave kulturore shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar, për të promovuar imazhin e vendlindjes e të shqiptarëve jashtë vendit dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.

INDIKATORËT: Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse në bashkëpunim me shtetin e Kosovës.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Ministria e Kulturës
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 15

Mundësimi i informacioneve rreth diasporës shqiptare dhe zhvillimin e komuniteteve jashtë vendit. Realizimi i një raporti vjetor ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi i shteteve ku duhet vepruar me përparësi nga politikat për diasporën.

INDIKATORËT: Mundësimi i informacioneve dhe realizimi i një raporti vjetor rreth diasporës shqiptare.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Instituti i Statistikave INSTAT

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 16

Realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta për fushën e migracionit dhe përfshirja e tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil.

INDIKATORËT: Trajnime të përgjithshme dhe të veçanta. Organizimi i trajnimeve periodike. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve. Hartimi i moduleve trajnuese.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Zëvendëskryeministri

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Drejtësisë

Masa 17

Nxitja e bashkëpunimit shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat janë me profile dhe trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Informimi publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

INDIKATORËT: Bashkëpunim shtetëror me institucionet e vendeve pritëse. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative. Informimi publik për ecurinë.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Drejtësisë

Masa 18

Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletëpalosje, faqe interneti etj.), që iu drejtohet komuniteteve shqiptare në diasporë, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre, si edhe për shërbimet që iu ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, si edhe nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

INDIKATORËT: Shpërndarja e informacionit në lidhje me statusin e të drejtave, si edhe shërbimet që iu ofrohen.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Instituti i Statistikave INSTAT

Ministria e Drejtësisë

Masa 19

Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.

INDIKATORËT: Hartimi i manualeve praktike. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Zëvendëskryeministri

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Drejtësisë

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 20

Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

INDIKATORËT: Kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën.

Ministria e Drejtësisë

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 21

Nxitja dhe intensifikimi i kontakteve të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtën e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende.

Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës.

INDIKATORËT: Kontakte të ngushta ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase, ndërgjegjësim për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Drejtësisë

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 22

Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë hartimi nga ministria përgjegjëse për diasporën të një raporti vjetor për gjendjen konkrete të emigranteve shqiptare, me propozime masash respektive për përmirësimin e asistencës për ta.

INDIKATORËT: Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve. Hartimi nga ministria përgjegjëse për diasporën të një raporti vjetor.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Ministria e Drejtësisë

Masa 23

Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë.)

INDIKATORËT: Negocimi për marrëveshjet dypalëshe me vendet pritëse. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Drejtësisë

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 24

Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Vlerësimi i informacionit periodik dhe konkluzioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës.

INDIKATORËT: Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë. Vlerësimi i informacionit periodik.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Drejtësisë

Masa 25

Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti.

Rivlerësimi në bashkëpunim me vendet e BE-së e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfituar edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

INDIKATORËT: Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit. Bashkëpunim me vendet e BE-së për projekte të veçanta.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financës dhe Ekonomisë

Masa 26

Vlerësimi dhe nxitja e migrimit qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë). Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t'i kalohet institucioneve përgjegjëse.

INDIKATORËT: Masat favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale; Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për tregjet e huaja të punës.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Masa 27

Organizimi i një programi të veçantë vjetor për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare duke organizuar aktivitete periodike në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjetit të bizneseve shqiptare në diasporë që tregtojnë prodhime të natyrave të tilla.

INDIKATORËT: Program vjetor për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Masa 28

Përgatitja e certifikatës së diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm ("Jam Shqiptar") i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar.

INDIKATORËT: Përgatitja e certifikatës së diasporës.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2020-s

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

KRIJIMI I NJË INSTRUMENTI TË DOBISHËM NË NDIHMË TË QEVERISË DHE AKTORËVE TË TJERË PËR TË PËRMIRËSUAR DHE FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN ME DIASPORËN DHE MIGRACIONIN E LIGJSHËM

PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË EKONOMINË KOMBËTARE

Masa 29

Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse.

Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre.

INDIKATORËT: Ndihmë për institucionet e mikrokreditimit; mbledhja vullnetare e donacioneve nga anëtarët e shoqatave të migrantëve.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 30

Organizimi dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikat e diasporës dhe migracionit. (Plotësimi i rrjetit edhe me emrat dhe detajet e studiuesve dhe nëpunësve shtetërorë nga agjencitë administrative që do të merren me politikat për diasporën.)

INDIKATORËT: Organizimi dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 31

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit "Ambasador i Kombit". Krijimi i rrjetit të ambasadorëve të kombit (formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje).

INDIKATORËT: Promovimi i personaliteteve. Krijimi i rrjetit të ambasadorëve.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 32

Krijimi i Regjistrit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që nxisin investitorët që të punësojnë staf të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre programeve, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëpriten dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja nëpërmjet një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë.

INDIKATORËT: Regjistri i Diasporës së Kualifikuar; programet kombëtare; vlerësimi i programeve; koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2020-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Agjencia Kombëtare e Diasporës

Masa 33

Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e bizneseve në diasporë. Krijimi i Regjistrit të Bizneseve të Diasporës si bazë për krijimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës si organizuese dhe ndihmuese në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore.

INDIKATORËT: Krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës; krijimi i Regjistrit të Bizneseve të Diasporës.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 34

Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në koordinim me bizneset blerëse në diasporë (krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në diasporë) për të ndërlidhur bizneset shitëse dhe blerëse brenda dhe jashtë vendit.

INDIKATORËT: Zhvillimi i aktiviteteve vjetore; krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 35

Rivlerësimi i festave kombëtare, fetare nëpërmjet një planifikimi të kujdesshëm aktivitetesh, në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jofitimprurëse, federatat sportive dhe promovimi nga institucionet përgjegjëse të Turizmit në tregje të rëndësishme, duke rritur ndjeshëm flukset turistike.

INDIKATORËT: Planifikim aktivitetesh dhe promovim për rritjen e flukseve turistike.

AFATI KOHOR: 6-mujori dytë 2019
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Kulturës
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Masa 36

Vlerësim vjetor për remitancat dhe politikat nxitëse bankare për diasporën shqiptare. Përpunimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të diasporës. Rivlerësim për marrjen e masave për të rritur flukset e dërgesave të migrantëve duke motivuar migrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri (si p.sh.: me anë të normave të favorshme të këmbimit, si dhe mundësia për t'i mbajtur ato në valutë të huaj).

INDIKATORËT: Vlerësim vjetor për remitancat; politika koherente dhe të plota për dërgesat; rivlerësim për të rritur flukset e dërgesave.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Banka e Shqipërisë

Masa 37

Rivlerësimi në marrjen e masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale dhe më pak të kushtueshme. Vendosja e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit për këtë çështje.

Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare (si p.sh.: letra me vlerë).

INDIKATORËT: Masa për kalimin formal të dërgesave; dialog me përfaqësuesit e sistemit bankar; tërheqja e dërgesave nëpërmjet produkteve financiare.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Banka e Shqipërisë

Masa 38

Krijimi i zyrave të posaçme administrative në institucionet përgjegjëse të ekonomisë për trajtimin e diasporës shqiptare sidomos në zbatimin e politikave të dërgesave të migrantëve dhe lehtësimin e tërheqjes së investimeve nga diaspora.

INDIKATORËT: Krijimi i zyrave administrative.
AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Zëvendëskryeministri
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 39

*Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës, si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime "*ad hoc*" për emigrantët (brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit).*

*INDIKATORËT: Rivlerësim për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare; Përcaktimi i shërbimeve "*ad hoc*" për emigrantët.*

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Masa 40

Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse, si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Evidentimi i shoqatave. Krijimi i një regjistri.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës
Ministri Shtetit për Diasporën
Akademia e Shkencave

Masa 41

Nxitja e organizimeve të Rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Organizime të Rrjetit të Grave në Diasporë; Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës; krijimi i një rrjeti bashkëpunimi me organizatat, institucionet dhe shoqërinë civile.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Masa 42

Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Krijimi i lehtësirave si p.sh.: botimi në gazeta, apo në faqe interneti e informacioneve që mundësojnë krijimin e grupeve profesionale dhe të interesave të përbashkëta. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve "homologe" në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre.

INDIKATORËT: Organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të diasporës; krijimi i lehtësirave; vendosja e kontakteve midis grupeve "homologe".

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Masa 43

Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.

INDIKATORËT: Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën

Ministria e Drejtësisë

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 44

Kryerja e fushatave sensibilizuese lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse, si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:

Publikim i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,

Botimi në gazetat shqiptare jashtë vendit,

Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,

Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit.

Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë. Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:

Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve;

Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës;

European Court in Human rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut;

European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe - Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës;

Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të Parlamentit Evropian;

Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së.

INDIKATORËT: Kryerja e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Raportimi periodik të rasteve për shkelje të të drejtave të migrantëve shqiptarë.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare për Diasporën.

Ministria e Drejtësisë

Masa 45

Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë" në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.

INDIKATORËT: Koordinimi dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Kulturës

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 46

Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, në përgatitjen e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor, lidhur kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka siguruar avantazhe (dentar, neurokirurgji, kardiokirurgji etj.).

INDIKATORËT: Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

PËRGATITJA E ADMINISTRATËS PËR NIVELIN E RI TË MARRËDHËNIES TË POLITIKËS SHTETËRORE ME DIASPORËN

Masa 47

Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional për ta nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje.

INDIKATORËT: Takime me rrjetet e biznesit dhe i shkëmbimit të informacionit.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 48

MEPJ-ja, përmes strukturave të saj të diplomacisë ekonomike, do t'i kushtojë një vëmendje të veçantë marrëdhënieve me diasporën shqiptare në botë për shfrytëzimin e potencialit ekonomik që kjo diasporë mbart në vetvete, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktivitetesh vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë me njëri-tjetrin dhe vendlindjen.

INDIKATORËT: Bashkëpunim me sektorin e biznesit privat dhe institucionet e linjës; përpilim i një programi aktivitetesh vjetore periodike.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 49

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikat kombëtare mbi diasporën. Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekteve stimuluese dhe aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Banka e të dhënave të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës; krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare, trajnimi i gazetarëve në diasporë.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Masa 50

Organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse, si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare.

INDIKATORËT: Rrjeti i informimit për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 51

Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërorë për informacionin të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me "kujdestarët" e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

INDIKATORËT: Cilësia e faqeve të internetit të institucioneve. Takime periodike me "kujdestarët" e faqeve të informacionit.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Agjencia kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 52

Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese, mbi:

- Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën;
- Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
- Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë;
- Ekzistencën e burimeve informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend.

Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

INDIKATORËT: Çështje për migracionin dhe diasporën; regjistrimi i migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës; ekzistencën e burimeve informative;

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2020-s

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Brendshme

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Masa 53

Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Realizimi dhe strukturimi i një kanali televizionit publik (dhe radios) për temën e diasporës.

Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare.

INDIKATORËT: Zonat e transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare; programet televizive për diasporën; Kanali televizionit publik (dhe radios) për diasporën; marrëveshje me mediat në vendet pritëse.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Masa 54

Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të universiteteve shqiptare me universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

INDIKATORËT: Krijimi i projekteve mediatike, promovimi i programeve të shkëmbimit dhe internship-it.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)

Akademia e Shkencave

Masa 55

Organizimi i një plan veprimi mediatik për nxitjen, tërheqjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për të siguruar eksplorimin e gjithë potencialit të saj dhe shfrytëzimin e të gjithë avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi.

Përgatitja nga institucionet përgjegjëse të turizmit e një fushate promocionale, për të tërhequr vëmendjen e atij segmenti të diasporës që është në kërkim të rrënjëve, kulturës dhe traditave të paraardhësve. Në bashkëpunim me sektorin privat të përgatitet një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe. Si ikona të kësaj fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg.

INDIKATORËT: Plan veprimi mediatik; përgatitja e një fushate promocionale; përgatitja e një paketë që siguron pritshmëritë e mësipërme dhe në raste të veçanta siguron prezantimin e bazave të gjuhës shqipe.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:

Ministri i Shtetit për Diasporën

Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Ministria e Kulturës

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH)

Masa 56

Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit i aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

INDIKATORËT: Komunitetet shqiptare të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës, me qëllim promovimin e tyre në Shqipëri.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Kulturës
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

Masa 57

Krijimi i mekanizmave administrativ në nivel qendror dhe lokal për ndihmën dhe transparencën, për të mbështetur investimet dhe kërkesat e të interesuarve në diasporë. Informimi i diasporës për mundësitë e investimeve në Shqipëri me anë të medias, bankave (internet, broshura) etj. dhe motivimi i migrantëve shqiptarë për të investuar të ardhurat e tyre në sektorë të veçantë të ekonomisë.

INDIKATORËT: Mekanizma administrativ në nivel qendror dhe lokal; informimi i diasporës për investimet me anë të medias, bankave (internet, broshura) etj. dhe motivimi për të investuar.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik çdo vit)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Masa 58

Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën amtare. Identifikimi i nevojave për kurse të gjuhës shqipe në vendet pritëse. Rivlerësimi i hartimit të kurrikulave standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe.

Identifikimi i vazhdueshëm i nevojave për mësim në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë.

INDIKATORËT: Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin; identifikimi i nevojave për kurse; Rivlerësimi i hartimit të kurrikulave për mësimdhënien; identifikimi i nevojave për fëmijët.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Akademia e Shkencave

Masa 59

Vlerësimi vjetor i nevojave për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësim periodik i kurrikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurrikulave të përbashkëta.

INDIKATORËT: Vlerësimi vjetor i nevojave; Përmirësim dhe zbatimi i kurrikulave me Kosovën.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 60

Krijimi i Regjistrit të Mësuesve në Diasporë dhe krijimi i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. Identifikimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. Promovimi i aktiviteteve arsimore me mësues e nxënës shqiptar në diasporë.

INDIKATORËT: Regjistri i mësuesve dhe krijimi i programeve mbështetëse; identifikimi i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve; promovimi i aktiviteteve arsimore.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Akademia e Shkencave

Masa 61

Krijimi i një strukture permanente, që do të ndjekë vlerësimin dhe sigurimin e teksteve shkollore të nevojshme. Ajo do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin mësim në kurset, që do të krijohen për këtë qëllim.

Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimdhënësve mbi kurrikulat e përbashkëta me Kosovën.

INDIKATORËT: Krijimi i një strukture permanente, për tekstet shkollore dhe trajnimin e mësuesve; sigurimi i teksteve shkollore dhe trajnimi i mësimdhënësve.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 62

*Zhvillimi i projektit "*e-book*" (shkarkimi* online *i teksteve shkollore të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materialet e nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.*

*INDIKATORËT: Projekti "*e-book*" për shpërndarjen e librave.*

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s
INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Akademia e Shkencave

Masa 63

Rishikimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse.)

Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse, për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende.

INDIKATORËT: Marrëveshje bashkëpunimi për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe;

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 64

Rishikimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Vlerësimi i kryerjes së një studimi të thelluar mbi numrin e studentëve shqiptarë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen.

Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit në kuadër të programeve studimore të donatorëve të ndryshëm për Shqipërinë.

INDIKATORËT: Orientimi i programeve/donatorëve për të cilat ka nevojë Shqipëria; studim mbi numrin e studentëve shqiptarë dhe fushat ku specializohen; Rivlerësimi për kushtin e kthimit në Shqipëri.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 65

Hartimi dhe miratimi i marrëveshjeve të nevojshme, të përbashkëta me Kosovën dhe të veçanta për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.

Rivlerësim për kuadrin ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe për brezin e ri të komuniteteve shqiptare në diasporë.

INDIKATORËT: Marrëveshjet me Kosovën; Rivlerësim i kuadrit ligjor.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 66

Promovimi i programeve apo donatorëve të cilët ofrojnë bursa për studime jashtë vendit, për Shqipërinë. Organizimi i aktiviteteve për informimin në shkollat e mesme dhe të larta me qëllim njohjen e këtyre programeve dhe procedurave të aplikimit si nga pedagogët, studentët apo nxënësit.

INDIKATORËT: Programe me bursa studimi; organizimi i aktiviteteve për informim.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Kostoja financiare do të përballohet brenda buxhetit të miratuar në institucionet zbatuese.

Masa 67

Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptare që studiojnë jashtë vendit dhe mbi faktorët që ndikojnë në këtë situatë. Organizimi në vendet pritëse për marrjen e masave për të mundësuar komunikimin dhe rrjetet funksionale në ndihmë të studentëve shqiptarë.

INDIKATORËT: Raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve dhe faktorët ndikues; organizimi në vendet pritëse për marrjen e masave.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Masa 68

Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV-në e migrantëve të kualifikuar.

INDIKATORËT: Nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar; krijimi i një banke të dhënash elektronike me CV-në.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministria e Brendshme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Kostoja financiare do të përballohet nga PBA-ja, i miratuar për institucionet zbatuese.

MONITORIMI

Masa 69

Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit mbi vlerësime 6-mujore dhe kryerja e raportimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën. Raportimi në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën në Kuvendin e Shqipërisë për ecurinë e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Nënkomisioni do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës Kuvendi çdo vit të miratojë një rezolutë për këtë çështje.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 70

Vlerësimi nga Nënkomisioni për Migracionin dhe Diasporën dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën në mbledhje të veçanta i dokumenteve të:

- Raportimit me shkrim i Agjencisë Kombëtare të Diasporës;
- Bankës së Shqipërisë për remitancat në Republikën e Shqipërisë;
- INSTAT-it për të dhënat vjetore për migracionin dhe diasporën;
- Institutit Shtetëror të Sigurimeve për informacionin vjetor për gjendjen e pensioneve dhe statusin e shtetasve jashtë vendit;
- Nga Ministria e Brendshme për gjendjen e regjistrimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Zëvendëskryeministri
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Brendshme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Banka e Shqipërisë

Masa 71

Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit në Samitin e Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme.

AFATI KOHOR: 6-mujori i dytë i 2018-s (periodik)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

Masa 72

Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve vjetore të masave të marra duke përfshirë të dhëna sasiore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar.

AFATI KOHOR: 6-mujori i parë i 2019-s (periodik çdo vit)

INSTITUCIONE PËRGJEGJËSE:
Zëvendëskryeministri
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme

GRUPI I PUNËS

1. Pandeli Majko,
ministri i Shtetit për Diasporën – kryetar
2. Sonila Qato,
ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes – anëtar
3. Etjen Xhafaj,
zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme – anëtar
4. Elton Haxhi,
zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë – anëtar
5. Besa Shahini,
zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë – anëtar
6. Valbona Shujaku,
zëvendësministri i Kulturës – anëtar
7. Hajrulla Çeku,
zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit – anëtar
8. Rovena Voda,
zëvendësministri i Brendshëm – anëtar
9. Teuta Vodo,
zëvendësministri i Drejtësisë – anëtar
10. Ardiana Jaku,
zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – anëtar
11. Ermira Gjeci Ruci,
zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – anëtar

URDHËR
Nr. 294, datë 15.5.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 611, DATË 1.12.2015, TË MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME, "PËR PROCEDURËN DHE RREGULLAT PËR DËRGIMIN E RASTIT, NGA AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN, TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR AZILIN DHE REFUGJATËT"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr. 121/2014, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë

URDHËROJ:

1. Pika 6 e urdhrit nr. 611, datë 1.12.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, i dërgohet një kopje e formularit të gjurmëve daktiloskopike dhe atij të përzgjedhjes, së bashku me një informacion për rastin, brenda 48 orësh nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, në postën elektronike zyrtare të këtij Autoriteti".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj

URDHËR
Nr. 305, datë 21.5.2018

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 29, ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Ministrisë së Brendshme z. Julian Hodaj, nga data 21.5.2018 deri në datën 24.5.2018.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj

VENDIM
Nr. 97, datë 23.4.2018

MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA ALBGAZ SHA, PËR VITIN 2018

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 13, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", si dhe nenit 19 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të

ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave, në lidhje me "Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2018",

konstatoi se:

- Shoqëria ALBGAZ sh.a., me shkresën nr. 85/1 prot., datë 3.1.2018, protokolluar në ERE me nr. 13 prot., datë 4.1.2018, ka paraqitur kërkesën "Për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror", sipas materialit që shoqëria i ka bashkangjitur kësaj kërkese.

- ERE, me vendimin nr. 90, datë 7.6.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për periudhën 5.1.2017–20.9.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017 dhe me vendimin nr. 14, datë 10.1.2018.

- ERE, me vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, ka miratuar *Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.*

- ERE, me vendimin e bordit nr. 20, datë 19.1.2018, vendosi "*Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018*".

- ERE, pas marrjes së vendimit nr. 20, datë 19.1.2018 "*Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018*", ka vijuar me dërgimin e këtij vendimi për publikim në mediat e shkruara kombëtare, si dhe në faqen e saj të internetit dhe palëve të interesuara për marrje mendimi. Në përfundim ka rezultuar se asnjë palë nuk ka shprehur opinionin/komente në lidhje me këtë aplikim.

- ERE, me anë të shkresës 13/1 prot., datë 26.1.2018, pas analizës së kryer këtij aplikimi i kërkoi nga shoqëria ALBGAZ sh.a. dokumentacion plotësues lidhur me çështjet e argumentuara në këtë kërkesë.

- Shoqëria ALBGAZ sh.a., me anë të shkresës nr. 13/3 prot., datë 20.2.2018, ktheu përgjigje në lidhje me kërkesat për informacion nga ana e Entit Rregullator të Energjisë.

- ERE, pas analizës së përgjigjeve të dërguara nga shoqëria, në datën 20.3.2018, organizoi një seancë dëgjimore teknike me përfaqësuesit e ALBGAZ sh.a. dhe Albpetrol sh.a. Në seancën dëgjimore teknike u diskutuan çështjet e paqartësuara, në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete, përgjigjeve shtesë të dërguara nga shoqëria, si dhe trajtimet teorike të metodologjisë përkatëse për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror. Në përfundim të seancës, u ra dakord që të dërgoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për komponentët e ndryshëm të të ardhurave të kërkuara për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018.

- ERE, në datën 30.3.2018, organizoi një tjetër seancë dëgjimore për të gjitha palët e interesuara në këtë proces, pas dërgimit të shpjegimeve shtesë mbi aplikimin për tarifën e transmetimit të gazit natyror për vitin 2018, nga ana e shoqërisë ALBGAZ sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a., për vitin 2018 prej 28 lekë/m^3 ose 2.6457 lekë/kwh.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 31, datë 27.4.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 4, DATË 29.2.2012, "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË KONSUMATORËVE PËR DISA KLIENTË TË VEÇANTË"

Në mbështetje të nenit 14, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, dhe bazuar në relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi:

Komisioni Kombëtar Rregullator, me anë të vendimit nr. 4, datë 29.2.2012, "Për përcaktimin

e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë", pika 1/b ka klasifikuar komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) në kategorinë e konsumatorëve publikë.

Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, me anë të shkresës nr. 4/18, datë 25.2.2018, me lëndë "Mbi nevojën e rishikimit të tarifës së furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për objektet e bashkësive fetare" iu drejtua Entit Rregullator të Ujit, me kërkesën për kategorizimin e objekteve të bashkësive fetare si konsumatorë familjarë, mbështetur edhe në praktikën e ngjashme me shërbimin e furnizimit me energji elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 4, datë 29.2.2012, "Për përçaktimin e kategorisë së konsumatorëve për disa klientë të veçantë", pika 1/b ndryshohet si më poshtë:

"Komunitetet fetare (selitë e tyre dhe objektet e kultit) të trajtohen në kategorinë "Klientë familjarë". Këtu bëjnë përjashtim ato institucione dhe struktura të krijuara nga këto komunitete të cilat ushtrojnë veprimtari arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, të cilat do të trajtohen në kategorinë "Klient privat".

2. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit të njoftojë të gjitha shoqëritë ujësjellës-kanalizime dhe përfaqësitë e bashkësive fetare.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1 qershor 2018.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 32, datë 27.4.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 2.3.2018, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME LIBOHOVË"

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", si dhe rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Libohovë, për licencim për efekt të ndryshimit të zonës së shërbimit, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Libohovë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 17, datë 2.3.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Libohovë";
- Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Libohovë iu la detyrë të aplikojë për zgjerim të zonës së shërbimit për njësitë administrative Qendër Libohovë dhe Zagorie, menjëherë pas reflektimit të tyre në QKB;
- Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Libohovë ka aplikuar, me anë të shkresës nr. 72 prot., datë 17.4.2018, për ndryshimin e licencës për efekt të zgjerimit të zonës së shërbimit;
- Aplikimi i shoqërisë sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Libohovë plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit mbi ndryshimin e zonës së shërbimit, konkretisht:
- sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Libohovë ka rritur kapitalin e shoqërisë duke zmadhuar vlerën e aseteve të shtuara sipas VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016;
- dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit nr. 17, datë 2.3.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Libohovë", ndryshohet si më poshtë:

"Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Libohovë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 33, datë 11.5.2018

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS GRAMSH SHA

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12. 2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 27.4.2018, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, të kërkesës së Ujësjellës Gramsh sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit furnizimit me ujë të pijshëm për zonat e reja që i janë bashkuar Ujësjellësit Gramsh, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

VËREN SE:

- Ujësjellës Gramsh sh.a. ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU-së, me shkresën nr. 677, datë 7.12.2017, me lëndë "Kërkesë për vendosje tarifë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm, si dhe tarifë fikse për zonat e reja të shërbimit që janë transferuar pranë shoqërisë sonë, referuar VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016".

- Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 8, datë 16.2.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjellës Gramsh sh.a., e cila ka propozuar të aplikojë për zonat e reja të njëjtin nivel tarifor që aplikon në zonën ekzistuese.

- ERRU-ja e konsideron nevojën e vendosjes së tarifave për zonat e reja si një domosdoshmëri në zbatim të akteve ligjore dhe të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

- ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike, ka kërkuar nga operatori informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

- ERRU-ja, në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë kostot totale për shërbimin e ofruar, në pamundësi të shoqërisë për t'i ndarë ato sipas zonave.

- Operatori ka propozuar kosto më të larta, për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 në vlerën prej 4.8 milionë lekësh, ndërsa të ardhurat janë parashikuar të rriten me rreth 2 milionë lekë. Prandaj nivelet e mbulimit të kostove të O&M dhe kostot totale janë parashikuar të pësojnë një rënie krahasuar me ato të vitit paraardhës.

- ERRU-ja ka gjykuar se shoqëria për vitin 2018 duhet të mbajë kostot në nivelin e vitit 2017, pra rreth 37.8 milionë lekë, sepse edhe gjatë vitit 2017 praktikisht shoqëria ka mbuluar kostot edhe për pjesën e zgjeruar të zonës së shërbimit (zona rurale).

- ERRU-ja gjykon se ka akoma rezerva në rritjen e të ardhurave duke qenë se mund të rritet niveli i faturimit, nga evidentimi i lidhjeve të paligjshme në lidhjen e kontratave respektive, gjithashtu, gjykon se mund të gjenden mekanizma të përshtatshëm për mbledhjen e borxheve.

- ERRU-ja konstaton se shoqëria Ujësjellës Gramsh sh.a. ka ende nevojë për subvencione për të mbuluar kostot totale.

- ERRU-ja, bazuar në informacionin e gjendjes së aseteve të shoqërisë, konstaton se shoqëria ka nevojë për investime emergjente dhe afatmesme, pasi rrjeti është shumë i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.

- Nga analiza e të dhënave, rezulton që tarifat e propozuara nga shoqëria janë në përputhje të plotë me parimin e rregullatorit mbi përballueshmërinë që fatura e llogaritur me tarifat e reja të mos jetë më shumë se 5% e shpenzimeve mesatare

mujore të një familjeje sipas të dhënave të INSTAT-it.

- Nisur nga analiza e treguesve të performancës, ERRU-ja konstaton se nga zgjerimi i zonës së shërbimeve është e paevitueshme që disa tregues të pësojnë rënie për një periudhë transitore, jo më shumë se dyvjeçare.

- Uji pa të ardhura parashikohet që në vitin 2018 të përmirësohet me -2.8%, kjo kryesisht do të vijë nga vendosja e matësve në burim e depo, prerja e lidhjeve të paligjshme, instalimi i matësve individualë, si dhe nga investimet që janë parashikuar të bëhen në rrjetin e ujësjellësit.

- Niveli i matjes është i ulët në nivelin 53%. Shoqëria raporton se e konsideron prioritet dhe aktualisht është në proces të instalimit të ujëmatësve. Shoqëria, brenda 4-mujorit 2018, ka instaluar pothuajse të gjithë matësit në klientët jofamiljarë dhe niveli i matjes është parashikuar të jetë 56%. Kjo do ta bëjë klientin të paguajë ujin që konsumon.

- Norma e arkëtimit aktualisht është rreth 86%, shoqëria ka bërë një plan masash për vjeljen e debive të prapambetura me qëllim që ky tregues për vitin 2018 të jetë 90%.

- Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë aktualisht është 84%, por legalizimi i lidhjeve të paligjshme dhe evidentimi i saktë i klientëve do ta përmirësojë me 2% këtë tregues.

- Mesatarisht shoqëria furnizon me ujë 20 orë në ditë. Ka zona si Bashkia Gramsh dhe disa fshatra që marrin ujë 24 orë. Për vitin 2018 ky tregues do të rritet me 1 orë më tepër furnizim me ujë të pijshëm për gjithë zonën e shërbimit.

- Treguesi staf/1000 lidhje është 7.8 punonjës. Për vitin 2018 ky tregues do të ulet me 0.4 punonjës. Rënia e këtij treguesi vjen për shkak të rënies së numrit të punonjësve në përputhje me nevojat reale të menaxhimit korrekt të shërbimit të furnizimit me ujë.

- ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e mësipërm të performancës, si dhe në zbatim të rekomandimeve të mëposhtme:

- shoqëria duhet të punojë fort në drejtim të evidentimit të saktë të të gjithë klientëve në zonën e shërbimit për të eliminuar praninë e konsumatorëve me lidhje ilegale;

- shoqëria duhet ta ketë prioritet instalimin e matësve në burim dhe në depot e ujit, si dhe hartimin e bilanceve të sakta të ujit për të përcaktuar saktësisht humbjet administrative dhe ato teknike;

- shoqëria duhet të hartojë, brenda vitit, Planin e Biznesit 5-vjeçar për të gjithë zonën e shërbimit;

- shoqëria duhet të përfundojë brenda një afati 2-vjeçar instalimin e matësve individualë për konsumatorët familjarë;

- shoqëria duhet të detyrojë të gjithë konsumatorët privatë dhe institucionalë që të pajisen me matës brenda vitit 2018;

- shoqëria duhet të hartojë një plan masash të detajuar agresiv për vjeljen e debive të prapambetura dhe në përputhje me kërkesat e reformës së ujit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Gramsh sh.a., si më poshtë:

Kategoria	**Tarifat volumetrike**	**Tarifa fikse shërbimi**
a. *Për shërbimin e furnizimit me ujë*	lekë/m^3	lekë/muaj
1. Konsumator familjar	32	60
2. Konsumator publik	90	150
3. Konsumator privat	90	180

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018, të jenë:

Treguesit e performancës	Viti 2017 (realizimi)	Viti 2018 (objektivi)
Mbulimi me ujë	84%	86%
Niveli i matjes	53%	56%
Uji pa të ardhura	41.8%	39%
Norma e arkëtimit	86%	90%
Orët e furnizimit me ujë	20 orë	21 orë
Staf për 1000 lidhje uji	7.8 punonjës	8.2 punonjës
Uji pa të ardhura	41.8%	39%

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës Gramsh sh.a. do të jetë 0,6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.6.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi nr. 54, datë 30.12.2016, "Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë U Gramsh sh.a., shfuqizohet.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 34, datë 11.5.2018

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME SKRAPAR SHA

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 27.4.2018, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, të kërkesës së Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime për zonat e reja që i janë bashkuar Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a., në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura",

VËREN SE:

- Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a. ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU-së, me shkresën nr. 337/1, datë 4.12.2017, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime";
- Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 9, datë 16.2.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a., e cila ka propozuar të aplikojë tarifa të unifikuara për zonën pas riorganizimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016.
- ERRU-ja e konsideron nevojën e vendosjes së tarifave për zonat e reja si një domosdoshmëri në zbatim të akteve ligjore dhe të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të shoqërive UK.

- ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike ka kërkuar nga operatori informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat i janë vënë në dispozicion.

- ERRU-ja, në analizën ekonomike financiare, në pamundësi të shoqërisë për t'i ndarë veç e veç dhe sipas zonave, shërbimet e furnizimit me ujë dhe ato të kanalizimeve të ujërave të ndotura mori në konsideratë kostot totale për të dyja shërbimet e ofruara.

- Operatori ka propozuar pothuajse të njëjtin nivel kostosh për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 dhe, konkretisht, 47 milionë lekë, ndërsa të ardhurat janë parashikuar të rriten me rreth 6.8 milionë lekë.

- ERRU-ja gjykon se ka akoma rezerva në rritjen e të ardhurave duke qenë se mund të rritet niveli i faturimit si rezultat i evidentimit të lidhjeve të paligjshme dhe legalizimit të tyre nëpërmjet lidhjes së kontratave përkatëse, si edhe gjetjes së mekanizmave të tjerë të përshtatshëm për mbledhjen e borxheve.

- ERRU-ja konstaton se shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Skrapar është në vështirësi financiare, pasi niveli i mbulimit të kostove O&M është rreth 48%.

- Shoqëria për një periudhë të paktën afatmesme ka ende nevojë për subvencione për të mbuluar kostot O&M.

- ERRU-ja, bazuar në informacionin e gjendjes së aseteve të shoqërisë, konstaton se shoqëria ka nevojë për investime emergjente dhe afatmesme, pasi rrjeti është shumë i amortizuar, sidomos në disa zona në të cilat mjaft asete kanë dalë jashtë përdorimit.

- Nisur nga analiza e treguesve të performancës, ERRU-ja konstaton se nga zgjerimi i zonës së shërbimeve është e paevitueshme që disa tregues të pësojnë rënie për një periudhë të përkohshme, e cila nuk duhet të zgjasë më shumë se dy vjet.

- Niveli i matjes prej rreth 6% është shumë i ulët. Shoqëria, duke qenë se e ka vendosur prioritet instalimin e ujëmatësve, brenda 4-mujorit 2018, ka instaluar pothuajse të gjithë matësit e klientëve të kategorisë jofamiljarë dhe pritet të instalojë matësit edhe për klientët e kategorisë familjarë, duke filluar nga zonat urbane dhe më tej tek ato rurale.

- Uji pa të ardhura parashikohet që në vitin 2018 të mbetet pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2017 (44%), kjo pasi aktualisht shoqëria nuk ka kapacitete financiare për vendosjen e matësve në çdo depo dhe vlerësimi i këtij treguesi mbetet fiktiv përderisa sasia e ujit të prodhuar nuk matet, por vetëm vlerësohet. Gjithsesi, evitimi gradual i lidhjeve të paligjshme pritet të kontribuojë në reduktimin e humbjeve.

- Norma e arkëtimit parashikohet të rritet me 2.7% pasi shoqëria raporton se ka një plan veprimi lidhur me eficiencën e mbledhjes së të ardhurave, e cila duket se ka dhënë rezultat nga arkëtimi i debive të vjetra, duke mbledhur rreth 5.7 milionë lekë për vitin 2017.

- Kohëzgjatja e furnizimit me ujë parashikohet të përmirësohet duke shërbyer me 10 orë në ditë ujë si rezultat i përmirësimit të menaxhimit të ujit të prodhuar, si edhe të ndonjë investimi të pritshëm në sistem.

- Efikasiteti i stafit për vitin 2018 parashikohet të përmirësohet si tregues me vlerën 0.25 si rezultat i rritjes së numrit të lidhjeve nga zgjerimi i zonës, e veçanërisht nga evidentimi i lidhjeve të paligjshme.

- Nga analiza e të dhënave rezulton që tarifat e propozuara nga shoqëria janë në përputhje të plotë me parimin e rregullatorit mbi përballueshmërinë që fatura e llogaritur me tarifat e reja të mos jetë më shumë se 5% e shpenzimeve mesatare mujore të një familjeje sipas të dhënave të INSTAT-it.

- ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës sipas propozimit të operatorit duke zbatuar rekomandimet e mëposhtme:

- shoqëria duhet të punojë fort në drejtim të evidentimit të saktë të të gjithë klientëve në zonën e shërbimit për të eliminuar praninë e konsumatorëve me lidhje ilegale;

- shoqëria duhet ta ketë prioritet instalimin e matësve në burim dhe në depot e ujit dhe hartimin e bilanceve të sakta të ujit për të përcaktuar saktësisht humbjet administrative dhe ato teknike;

- shoqëria duhet të përfundojë brenda një afati 3-vjeçar instalimin e matësve individualë për konsumatorët familjarë;

- shoqëria duhet të hartojë një plan masash të detajuar e agresiv për vjeljen e debive të prapambetura dhe në përputhje me kërkesat e reformës së ujit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Skrapar sh.a., si më poshtë:

Kategoria	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse shërbimi
Për zonën urbane me dhe pa matës		
a. *Për shërbimin e furnizimit me ujë*	lekë/m³	lekë/muaj/klient
1. Konsumator familjar	35	100
2. Konsumator publik	100	100
3. Konsumator privat	110	100
b. *Për shërbimin e kanalizimeve*		
1. Konsumator familjar	10	0
2. Konsumator publik	10	0
3. Konsumator privat	10	0
Për zonën rurale pa matës		lekë/muaj/klient
1. Konsumator familjar	0	300
2. Konsumatorë nga burime dytësore	0	125

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018, të jenë si më poshtë:

Treguesit	Viti 2017	Objektivat për vitin 2018
Mbulimi me ujë	93%	96%
Mbulimi me kanalizime	39%	41%
Niveli i matjes	6%	20%
Uji pa të ardhura	44%	44%
Norma e arkëtimit	82%	84.7%
Orët e furnizimit me ujë	7.5 orë	10 orë
Staf/ 1000 lidhje uji	10 punonjës	9.75 punonjës

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Skrapar sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.6.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

5. Vendimi nr. 10, datë 15.3.2010, "Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë U Skrapar sh.a.", shfuqizohet.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë